

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
SOUTH-EAST EUROPEAN UNIVERSITY
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА

FAKULTETI JURIDIK
LAW FACULTY
PRAVNIOT ФАКУЛТЕТ



STUDIME POSTDIPLOMIKE-CIKLI I DYTË

Teza:

**“VIKTIMAT E ABUZIMIT ME ALKOOL DHE SUBSTANCAT
NARKOTIKE”**

MENTOR:
Doc.Dr.Besa Arifi

KANDITAT:
Rabije Dervishi

Tetovë, 2016

PËRMBAJTJA

Mirënjohje.....	5
1.Hyrje.....	6

KREU I

2. Viktimat e abuzimit të alkoolit dhe substancave narkotike	8
2.1 Viktimat e abuzimit të alkoolit.....	8
2.1.1 Alkoolizmi dhe kriminaliteti.....	9
2.1.2 Shërbimi i të miturve me alkool.....	12

KREU II

3. Ndikimi i faktorëve socio-patologjik.....	12
3.1 Alkoolizmi.....	12
3.2 Narkomania.....	13
3.2.1 Veçoritë individuale të narkomanëve.....	14
3.2.2 Raporti i narkomanisë me kriminalitetin dhe parandalimi.....	15
3.3 Narkomania dhe kriminaliteti.....	17
3.3.1 Kuptimi i narkomanisë dhe veçoritë kryesore.....	17
3.3.2 Nga ç'familje janë narkomanët.....	18

KREU III

4. Viktimat e abuzimit dhe varshmërisë nga substancat narkotike.....	20
4.1 Përkufizimet e narkotikëve dhe substancave psikotrope.....	21
4.2 Historia e narkotikëve.....	21
4.3 Veprat lidhur me narkotikët dhe substancat psikotrope.....	22

KREU IV

5. Ç'është droga.....	23
------------------------------	-----------

5.1 Llojet e drogave dehëse,klasifikimi dhe substancat narkotike.....	23
5.1.1 Përdorimi dhe përdorimi abuziv.....	32
5.1.2 Varësia nga droga dhe toksikomania.....	33
5.1.3 Kriza e mungesës dhe shkallëzimi.....	34
5.2 Duhani-drogë.....	35
5.3 Stresi dhe droga.....	36
5.4 Droga dhe krimi. Të inkriminuar apo të sëmurë.....	37
5.5 Trafikimi i drogës Shqipëri-Maqedoni.....	38
5.5.1 Me çfarë drogohen shqiptarët.....	39
5.5.2 Kush e përdorin drogën.....	39
5.5.3 Motivet nxitëse për të filluar drogën.....	40
5.5.4 Terapia ose si të shpëtojmë nga droga.....	40
5.5.5 Vullneti çelësi i artë.....	41
5.6 Toleranca ndaj drogës dhe mbidoza.....	42
5.7 Parandalimi i përdorimit të drogës tek fëmijët dhe adoleshentët.....	42
KREU V	
6. Cilat janë 5 kategoritë e përdorimit të drogës.....	44
6.1 Drogat dhe efektet e tyre.....	44
6.1.1 Ndikimi tek individit.....	45
6.1.2 Ndikimi në familje.....	46
6.1.3 Statistikat e veprave penale të kryera nga person i mvarur nga alkooli dhe substancat narkotike në periudhën 2014-2016 Kërçovë.....	47

KREU VI

7.Mjekimi i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve.....50

7.1 Procedura për shqiptimin e masës së sigurimit mjekim i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve.....54

7.2 Trajtimi me anë të rehabilitimit të detyrueshëm i personave të varur nga droga dhe alkooli.....54

7.3 Dënimi me kusht me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues.....56

7.4 Ekzekutimi i trajtimit të rehabilitimit të detyrueshëm të personave të varur nga droga dhe alkooli.....56

KREU VII

8. Shkurtesat.....58

9.Përfundime dhe rekomandime.....59

10.Bibliografia.....61

Mirënjohje

Do të dëshiroja të shpreh mirënjohjen time të thellë ndaj mentorit tim, Prof.Dr.Besa Arifi, e cili shprehu vullnetin e saj që të jetë mentore e kësaj teme të magjistraturës. Inkurajimi, udhëzimet dhe vëmendja e të cilës ,që nga faza fillestare e deri në fazën përfundimtare mundësoi që më së miri të zhvillojë kuptimin e këtij studimi.

Shtytja e saj e pakompromis për përsosmëri ishte thelbësore për përcaktimin e cilësisë së këtij punimi. Është nder për mua dhe privilegj i madh që kam qenë studente e saj si dhe gjatë disertacionit kam qenë nën mbikqyrjen e saj.

Falenderimet e mia i drejtohen edhe antarëve të komisionit, Prof.Dr.Ismail Zejneli ,si dhe Doc.Dr.Blerton Sinani, për përkrahjen e tyre dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm, për këshillat e tyre dhe komentet e vlefshme.

HYRJE

Dëshira për të shkruar një temë për alkoolin dhe substancat narkotike më lindi pikërisht nga kjo përvojë... Kam përpara syve një numër të madh personash të vërtetë, personazhe realë, aktorë të dramës së tyre. I droguari ka të drejtë të marrë disa njohuri për çfarë po i ndodh atij vetë, ndoshta leximi i kësaj teme do ta ndihmojë.

Familjari i tij është i pranishëm në këtë tragjedi. Ndoshta edhe ai do të ndihmohet. Politikani dhe personi publik ka përgjegjësinë që të bëjë ligje dhe t'i zbatojë ato. Ndoshta kjo temë do të ndikojë sado pak që edhe politika shurdhe shqiptare të zgjohet më në fund e të fillojë të mendojë për njerëzit, të merret seriozisht edhe me këtë plagë të shoqërisë.

Duke parë dinamikën e perhapjes së një dukurie kriminale mjaft të dëmshme e cila quhet "Alkool" dhe substancave tjera narkotike, problematikat që sillen këto fenomene jo vetëm në aspektin mjekësor e social por edhe në aspektin juridik kanë bërë që të tërhiqet vëmendja edhe e juristëve dhe të opinionit për të luftuar dhe parandaluar ato në të gjitha format e mundshme, në mënyrë të organizuar. Njerëzit që abuzojnë me alkoolin dhe substancat tjera narkotike përveçse dëmtonin rëndë shëndetin e tyre shëndrroheshin në persona asocial, duke qenë kontigjenti shoqëror më i prirur për të kryer krime të ndryshme. Përzgjedhja e kësaj teme ka marrë syzgjërim nga problematika juridiko-penale dhe problemet e shumta që dolën si shkak i këtij fenomeni.

Punimi trajton problematika të shumta të shkruara p.sh. nga motivet nxitëse për të filluar me substancat narkotike, fillimi i përdorimit të tyre, varësia nga substancat psikotrope, kriza e mungesës dhe shkallëzimi, e deri te viktimat e abuzimit me substancat narkotike dhe raporti i narkomanisë me kriminalitetin midis të cilave një vend të rëndësishëm zë edhe importimi me tregëtim, eksportimi i substancave si dhe trajtimi, terapitë e ndryshme dhe parandalimi i këtyre fenomeneve.

Ky punim synon të jetë një kontribut në fushën e së drejtës penale nëpërmjet një trajtimi gjithëpërfshirës të kuadrit ligjor.

Punimi përbëhet prej shtatë kapitujve, ku kam shqyrtuar:

Në kreun e parë shqyrtohet viktimat që janë abuzuar nga personat që kanë qenë nën ndikim të alkoolit, krimet që kanë kryer, si dhe shërbimi i të miturve me alkool e cila është e ndaluar rreptësisht me ligj.

Në kreun e dytë sqarohet alkoolizmi, narkomania, veçorit individuale të narkomanëve. Gjithashtu kemi edhe raportin e narkomanisë me kriminalitetin dhe si vjen deri te parandalimi i veprave penale që kryejnë narkomanët.

Në kreun e tretë kam shqyrtuar personat që kanë rënë viktime nga kryerësit që janë në varshmëri nga substancat narkotike, psikotrope si dhe veprat që kanë kryer personat nën ndikimin e e varshmëris të atyre substancave.

Në kreun e katërt kam cekur drogën, llojet e drogave dehëse, si klasifikohen drogat dhe substancat narkotike. Kur personat e përdorin drogën, pastaj si ato bëhen të varur nga droga. Ata persona çfarë bëjnë në qoftë se kanë mungesë të drogës. Gjithashtu kamë cekur edhe trafikimin e drogës Shqipëri- Maqedoni , me çfarë drogohen shqiptarët, kush e përdorin drogën. Si vjen deri te nxitja e personit për të marrë drogë. Dhe në fund kam shqyrtuar sesi mund të shpëtohet nga droga që mos të vijë deri te marrja e mbidozës.

Në kreun e pestë kemi të bëjmë me drogat dhe efektet që japinë drogat pas marrjes, si ndikon marrja e drogës tek individi, si dhe në familjet e tyre.

Në kreun e gjashtë dhe të fundit të këtij punimi kam shkruar për mjekimin e alkoolistëve dhe narkomanëve. Ku së pari ndaj alkoolistëve apo narkomanëve zhvillohet një procedur për shqiptimin e masës së sigurimit mjekim i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve. Gjithashtu bëhet edhe trajtimi i detyrueshëm i personave të varur nga droga dhe alkooli, në qoftë se personi nuk i nënshtrohet këtij rehabilitimi do të ketë dënim me kusht për t'iu nënshtrohet këtij trajtimi të detyrueshëm.

Do të dëshiroja shumë që ky punim të binte në dorë të të rinjëve, sidomos të rinisë qytetare, e cila masivisht po bën pjesë në grupet e rrezikuara nga alkooli dhe substncat narkotike.

KREU I

1.VIKTIMAT E ABUZIMIT TË ALKOOLIT DHE SUBSTANCAVE NARKOTIKE

1.1 Viktimat e abuzimit të alkoolit

Në shoqërinw bashkëkohore është në rritje edhe numri i viktimave të sëmundjeve sociale dhe varësisë nga to. Kërkimet viktimologjike, por edhe studimet kriminologjike, tregojnë për praninë e madhe të patologjive, që si faktor kryesor të nxitjes kanë varësinw nga alkooli apo substancat narkotike. Alkoolistët dhe narkomanët, në statistikat kriminale dhe viktimologjike, sot i hasim si kryerës të sjelljeve devijante apo kriminale, por edhe si viktima.

Trajtimi dhe rehabilitimi i tyre është një ndër brengat serioze të shoqërive në tërë globin tokësor. Dhuna në familje, dhuna ndaj fëmijëve, vrasjet, plagosjet, dëmtimet trupore dhe pasojat e tjera materiale, të cilat i shkaktojnë alkoolistët, janë të shumta. Sipas të dhënave të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, 5,6% të të gjithë vdekjeve te meshkujt dhe 3,2% te femrat në tërë botën ndodhin për shkak të alkoolit.

Në botë sot thuhet se ka afro 2 miljardë njerëz që konsumojnë pije alkoolike dhe 76,3 milionë konsumues të alkoolit me çrregullime të diagnostikuara shëndetësore, pra si viktima të përdorimit të tij. Alkooli dhe përdorimi i tij radhitet si faktor numër një i moralitetit në shtetet e zhvilluara, ndërsa në shtetet me zhvillim radhitet si faktor i tretë. Ndër viktimat e alkoolizmit vërehet pjesëmarrja e madhe e të rinjëve, ose e grupmoshave 15-29 vjeç.¹



Fig.1.Viktima nga alkooli

¹ WHO Global Status Report on Alkool,2004,f.54-8

1.1.1 ALKOOLIZMI DHE KRIMINALITETI

Alkoolizmi si dukuri socio-patologjike, gjithëashtu është mjaft i përhapur në botën bashkëkohore. Me alkoolizëm nënkuptohet konsumimi i tepërt i pijeve alkoolike dhe krijimi i gjendjes së varshmërisë të personat që konsumojnë alkoolin. Për këtë arsye, alkoolizmi është objekt i interesimit dhe studimit intensive të ekspertëve nga lëmenj të ndryshëm.

Alkoolizmi si dukuri dhe problem, mund të vështrohet nga aspekti medicinal, social dhe kriminal.²

Konsumimi i alkoolit mund të paraqitet në dy mënyra, si: **dehje akute dhe dehje kronike.**

Dehja akute mund të jetë e lehtë dhe e rëndë. Me këtë rast, kemi të bëjmë me përdorimin e alkoolit në mënyrë jo të rregullt. Dehja pason për arsye se është konsumuar një sasi e madhe e alkoolit dhe te personi shkaktohet një gjendje patologjike, e dehjes së rëndë, e cila nëse përsëritet shpesh, sjell të ashtuquajturin alkoolizëm kronik.

Alkoolizmi apo dehja kronike është ajo kur individ i konsumon pije alkoolike në mënyrë të rregullt dhe në sasi të mëdha. Në këto raste, ky konsumim, te individ i caktuar, sjell varshmërinë e organizmit nga alkooli. Kjo mënyrë e konsumimit, shkatërron shëndetin shpirtëror dhe fizik të personit që konsumon në këtë mënyrë alkoolin. Zakonisht kur flitet për alkoolizmin dhe pasojat e tij negative mendohet për këtë formë të alkoolizmit.

Sepse çdo përdorim i pijeve alkoolike, e veçmas pija në sasi të vogël, në disa raste, nuk mund të cilësohet si alkoolizëm, në kuptimin e dukurisë socio-patologjike me pasojat të rënda shoqërore. Në literaturën kriminologjike, lidhur me konsumimin e alkoolit dhe ndikimin e tij në jetën dhe shëndetin e individëve, ka mendime dhe pikëpamje të ndryshme. Në këtë drejtim lidhur me përdorimin e alkoolit dhe varshmërisë, e cila krijohet nga ai në literaturë, përmenden disa stadime dhe faza të rrugës nëpër të cilën kalon individ, prej momentit kur fillon të konsumoj alkoolin e derisa shëndërrohet në alkoolist kronik, pra deri sa bëhet i varur nga ai.

Kësisoj përmendet **faza e parë** e cila manifestohet me konsumimin e pijeve alkoolike, kohëpaskohe, dhe e cila në ambientin e caktuar social e familjar nuk konsiderohet si dukuri e dëmshme dhe jonormale.

Faza vijuese është kur individ i konsumon në mënyrë të rregullt alkoolin dhe dozat e konsumimit i rrit në mënyrë të dukshme. Në këtë fazë, individ i alkoolin e konsideron si stimulans për punë dhe aktivitet, gjoja konstruktive të tij.

Faza tjetër është gjendja kur individ i duke konsumuar sasi të caktuara të alkoolit, humb kontrollin mbi faktin se sa dhe çfarë mënyre ka konsumuar pije alkoolike.

Dhe në fund, është faza e ashtuquajtur kronike, e cila paraqet një gjendje të dehjes së rëndë. Te individ i cili konsumon alkoolin në mënyrë kronike, vërehet dobësimi i proceseve mendore, shenja të çrregullimeve mentale e shpirtërore, paraqitja e psikozave alkoolike, dobësimi i organizmit dhe shkatërrimi i disa funksioneve vitale organike, si ai i sistemit nervor dhe i sistemit të enëve të gjakut.

² T.Markovic:Alkoholizam,Zagreb,1956,fq.12-124

Te këta individë, vërehet një pasiguri dhe mosbesim në vete dhe në mjedisin e caktuar. Kjo është faza më e rëndë e cila vrehet te alkoolistët.³

Alkoolizmi si **problem medicinal**, paraqet një sëmundje e cila shkatërron shëndetin fizik dhe psikik të individit. Në këtë drejtim personat të cilët konsumojnë alkoolin, në mënyrë kronike shkatërrohen dhe te ata paraqiten një varg sëmundjesh të natyrës psikike por edhe organike, si pasoj e ndikimit shkatërrimtar të alkoolit.

Alkoolizmi si **problem social** paraqet një dukuri mjaft të përhapur në shoqërinë bashkëkohore dhe zakonisht është e lidhur me paraqitjen e skamjes, varfërisë, papunësis, me migrimin dhe lëvizjet e mëdha të popullsisë, dezorganizimet individuale dhe shoqërore. Nga kërkimet e ndryshme empirike që janë bërë lidhur me dukurinë e alkoolizmit dhe pasojat e tij individuale dhe shoqërore, është vërtetuar se te individët që konsumojnë alkoolin në mënyrë kronike, vërehet një shkatërrim fizik dhe moral. Te këta individë, vërehet dobësimi fizik, topitja e konsiderueshme e ndjenjave dhe vetive të caktuara që kanë të bëjnë me karakterin, temperamentin, moralin, përgjegjësin ndaj familjes, kujdesi ndaj fëmijëve, ndaj vendit të punës, ndaj ambientit dhe rrethit të caktuar shoqëror.

Te alkoolistët kronikë, veçmas thekësohet lënia pas dore e kujdesit ndaj fëmijëve, ndaj bashkëshortit apo prindërve, çka pastaj, si pasojë ka edhe paraqitjen e çrregullimeve dhe konflikteve të mëdha familjare.

Personi alkoolist nuk është i kujdesshëm as për dukjen dhe dinjitetin e vet. Humb ndjenjën e krenarisë dhe të nderit. Shpesh bëhet servilë, rrenacak, lëvdohet tepër, në disa raste është agresiv dhe i vrazhdë, sidomos ndaj antarve më të afërm të familjes ose të shoqërisë së tij. Këta persona, shpeshherë, më së miri veten e ndjejnë në lokalet ku pihet alkooli, në kafe dhe lokale ku gjenden edhe persona të tjerë që konsumojnë alkoolin.

Alkoolistët kronikë ndikojnë në mënyrë destruktive në gjeneratat e reja, në formimin dhe edukim të fëmijëve, shkatërrojnë materialisht familjen për arsye se të gjithë mjetet që disponon familja ata i përdorin për kënaqjen e dëshirës patologjike për pije, ndërsa për nevojat tjera të familjes nuk i ngel asgjë.

Po ashtu, konsumimi i tepërt dhe në mënyrë kronike i alkoolit, dëmton shumë funksione intelektuale të personalitetit. Kështu, shpeshherë personaliteti i alkoolistit pëson ndryshime të mëdha. Në këtë mënyrë, këta individë, nuk kanë aftësi të koncentrimit, humbin mundësinë e preceptimit të ngjarjeve, të ambientit dhe të hapsirës. Te ata shfaqet harresa, amnesia dhe ngushtimi i një varg aftësive psikike. Ata shpesh nuk kanë mundësi që të dallojnë disa procese dhe dukuri në ambientin e vet. Në një fazë të caktuar, te këta persona, paraqiten e ashtuquajtura gjendje e psikozës alkoolike që shoqërohet me delirium dhe halucinacione të tjera.

Gati të të gjithë alkoolistët kronikë vërehen këto ecure të shkatërrimit të personalitetit, dhe të gjitha këto, në fund sjellin aktivitete negative dhe kriminale të tyre.

Personat alkoolist kronikë në këtë drejti humbin ndjenjën normale njerëzore. Tek ata zbehen vetitë jetike dhe ndryshohet karakteri i tyre njerëzor.

³ T.Markovic:Alkoholizam,Zagreb,1956,fq.12-124

Punimet e shumta shkencore dhe profesionale, si dhe hulumtimet e bëra lidhur me alkoolizmin dhe pasojat e tij në shoqëri, tregojnë se alkoolizmi dhe pasojat e tij në shoqëri, tregojnë se alkoolizmi paraqet një të keqe të madhe në shoqërinë bashkëkohore.

Alkoolizmin e shkakton paraqitja e papunësisë, braktisja e familjes, shkurorëzimi, prostitucioni dhe shkaqe të tjera. Alkoolizmi, ka lidhje të caktuar edhe me kryerjen e një varg aktiviteteve delikuede dhe kriminale. Në këtë drejtim posaçërisht përmenden rastet e krimeve të vrasjeve, lëndimeve trupore, plaçkitjeve, fyerjeve, shpifjeve, dhunimeve seksuale, delikteve në trafik, maltretimi dhe lënia pas dore e kujdesit ndaj familjes etj., si veprime të cilat kryhen drejtpërdrejt në ndikimin e gjendjes së dehjes kronike.

Personat që gjenden në trafik, qoftë si vozitës apo si udhëtarë kalimtarë të cilët janë në gjendje të dehjes, në mënyrë permanente rrezikojnë jetën e qytetarëve. Nga të dhënat e shënimeve nga praktikatat gjyqësore dhe rezultatet e kërkimeve shkencore, vërtetohet se përqindjet më të mëdha të fatkeqësive të rënda në trafik, janë shkaktuar nga personat të cilët kanë qenë në gjendje të dehjes, qoftë si vozitës apo si pjesëmarrës në trafikun publik. Personat të cilët janë në gjendje të dehjes dhe konsumojnë alkoolin në mënyrë kronike, nuk janë të aftë të drejtojnë automjete dhe aftësia e tyre për perceptimin e hapësirës, kohës, vendit, objekteve, shenjave të komunikacionet, shpejtësisë së lëvizjes, janë dukshëm të zvogluara ose krejtësisht të pamundura.

Për këtë arsye, në shumë vende, janë bërë përpjekje që vozitësve të tillë t'u ndalohej mundësia e përdorimit të alkoolit. Kësisoj, nëpër rrugë automobilistike, bëhen kontrollime dhe teste të gjendjes së vozitësve dhe pjesëmarrësve të tjerë, duke kontrolluar praninë e alkoolit në gjak etj. Me qëllim të pengimit të rritjes së dukurisë së alkoolizmit në shoqëri, e veçmas duke i vërejtur pasojat negative që shkakton kjo dukuri, në shumë vende janë bërë përpjekje për ndërmarrjen e masave parandaluese të një spektri të gjërë. Kësisoj thekësohet nevoja e njohjes dhe evitimit të shkaqeve shoqërore dhe individuale që shpien te alkoolizmi.

Posaçërisht, insistohet në ndërmarrjen e masave medicinale dhe shëruese në fazën e parë të paraqitjes së dukurisë së alkoolizmit.

Po ashtu, flitet për nevojën e ndërmarrjes së disa masave administrative dhe juridiko-penale. Në këtë drejtim, posaçërisht insistohet në ashpërsimin e kontrollit të trafikut dhe të kritereve të dhënies së lejeve për vozitje. Insistohet që nëpër kafe dhe lokale të ndryshme, të respektohet ndalesa e shërbimit me pije alkoolike për persona që janë alkoolist kronikë ose për persona të mitur dhe kërkohet që disa veprime të tilla, të inkriminohen si vepra penale etj. Sot në disa vende të botës, si veprime të cilat janë të drejtuara në pengimin e paraqitjes së sjelljeve kriminale, si pasojë e alkoolizmit janë paraparë: ndalimi i shërbimit me alkool të personave të mitur, vozitja në ndikimin e alkoolit ose në gjendje të dehjes etj.

Në teori dhe në praktikë, ekziston një bindje se alkoolizmi si dukuri patologjike dhe negative, nuk mund të luftohet vetëm me masa represive dhe ndalesa administrative, por është i nevojshëm një angazhim më i madh i institucioneve shtetërore, sociale edukative- arsimore për evitimin e tij, e sidomos për pengimin e rrethanave dhe kushteve shoqërore të cilat e kushtëzojnë paraqitjen e dukurisë së alkoolizmit.

Në literaturë përmendet roli dhe rëndësia e institucioneve të veçanta shëndetësore, pastaj shoqatave, klubeve dhe asociacioneve të tjera të cilat merren me pengimin e paraqitjes së alkoolizmit, shërimit medicinal të alkoolistëve, rehabilitimit psikik dhe social si dhe kyçjes së tyre në jetën e përditëshme. Ekziston bindja se vetëm në këtë mënyrë mund të pengohet alkoolizmi si dukuri e dëmshme dhe negative në shoqëri.⁴

1.1.2 Shërbimi I të miturve me alkool

Alkoolizmi paraqet dukuri socio-patologjike e cila paraqitet me përdorimin e tepërt të alkoolit, që lë pasoja të rënda në sferën e shoqërisë dhe në formimin e personalitetit të njeriut. Këtë vepër penale e kryen ai i cili në lokalin hotelarik apo në tjetër lokal apo në vende tjera ku shërbehen pije alkoolike, do t'i shërbej edhe personat e mitur.

Kryerës i kësaj vepre penale është çdo person që i shërbejn të miturit me pije alkoolike në lokalet apo në vendet tjera ku shërbehet alkooli. Lidhur me fajësinë, kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje e cila duhet të përfshijë në vete edhe vetëdijen e kryerësit të veprës se është duke i shërbyer personat e mitur me pije alkoolike.

Për këtë formë të veprës penale është paraparë dënimi me gjobë ose dënimi me burgim deri në 6 muaj. Forma më e rëndë e kësaj vepre është e paraparë në parag.2, e cila konsiderohet se kryhet në rastet kur me pije alkoolike shërbehet personi i mitur i cili është në gjendje të dehur dhe kryerësi do të dënohet me dënim me gjobë apo me dënim me burgim deri në 1 vit.⁵

⁴ R.Halili:Aspekte juridike dhe kriminologjike të alkoolizmit dhe narkomanisë.Përparimi, nr.2. Prishtinë,1984,fq.173-185

⁵ Neni 204 I Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë

KREU II

2. NDIKIMI I FAKTORËVE SOCIO- PATOLOGJIK

2.1 Alkoolizmi

Alkoolizmi paraqet dukuri asociale e cila paraqitet me përdorimin e tepërt të alkoolit, që lë pasoja të rënda në sferën e shoqërisë dhe në formimin e personalitetit të individit.⁶

Alkoolizmi te të miturit krijon situata të atilla që mundëson personi i mitur lehtë t'u nënshtrohet sjelljeve të ndryshme delikuede. Sa i përket përhapjes së alkoolizmit në terriore të ndryshme, nuk duhet të konsiderohet se kjo dukuri kryesisht është karakteristike vetëm për rrethin urban, por alkoolizmi është prezent edhe tek të miturit në mjediset rurale, por në masë më të vogël.

Pasojat e alkoolizmit gjithashtu vërehen edhe në komunikacion.

Alkooli negativisht ndikon në masë të madhe në aftësit e vozitësit dhe në koncentrimin e tij.

Sipas disa autorëve të shteteve të ndryshme, përqindja e vozitësve të dehur në fatkeqësi automobilistike sillet mbi 50% për këtë arsye në shumë vende në udhëkryqe të mëdha të trafikut përveç shenjave të tjera dhe të mëdha, të theksohet edhe vërejtja dhe porosia për vozitësit:

“VOZITËS, NËSE KE PIRË MOS VOZIT, NËSE VOZIT MOS PI”.⁷

Me qëllim të pengimit të rritjes së dukurisë së alkoolizmit në shoqëri, e veçmas duke i vërejtur pasojat negative që ka kjo dukuri, kohëve të fundit po ndërmerren masa parandaluese të një spektri më të gjerë.

Shkenca dhe analizat empirike tregojnë për një lidhje në mes të alkoolizmit dhe kriminalitetit.

Kështu hulumtimet tregojnë se nën ndikimin e alkoolizmit si një dukuri e veçantë kryhen veprat penale të vrasjes, lëndimeve të lehta, maltretimeve, kërcënimeve, dhunimeve, veprave penale kundër pasurisë si dhe kundërvajtjeve në komunikacion.⁸

Alkoolizmi shpesh çon kah paraqitja e dukurive të vrasjes, lëndimeve trupore, kërcënimeve, dhunimeve, maltretimn e antarëve të familjes, veprës penale kundër pasurisë dhe delikte në komunikacion. Alkoolizmi dhe kriminaliteti kanë ndikim të përbashkët, kështu që alkoolizmi paraqet shkak të drejtpërdrejt për kryerjen e disa veprave penale nga ana e të miturve, dhe veçmas të paraqitjes së përsëritësve të mitur (recivistëve).

Alkoolizmi lë pasoja të rënda te personaliteti i individit, kurse pasojat janë më të rënda nëse bëhet fjalë për persona të mitur.⁹

2.2 Narkomania

Narkomania është term i përgjithshëm që sot shfrytëzohet për të gjitha llojet e varësisë nga drogat e llojllojshme. Sipas WHO-së (Organizatës Shëndetësore Botërore) dhe mendimeve

⁶ Dr.M.Milutinovic, Kriminologjia, Beograd,1981, fq.373

⁷ Po aty;

⁸ T.Kralev,Kriminologjia na soobraqajnata delikvencija,Skopje,1998,fq.198

⁹ Dr.Markovic,Maloljetnicka delikvencija I njezino suzbivanje, Beograd,1973,fq.173

të ekspertëve të narkomanisë në vitin 1957, me nocionin narkomani nënkuptohet gjendja e intoksikacionit periodik ose kronik, të shkaktuar me futjen e sërishme ose të përhershme të drogës në trup.¹⁰

Shoqërimi i njeriut me drogën ka filluar para shumë mileniumesh respektivisht atëherë kur njeriu ka kuptuar se jeta është e varur nga natyra, dhe se jeta zhvillohet në natyrë dhe është e lidhur me natyrën. Prania e drogave në shoqërinë bashkëkohore, e sidomos marrja masovike e të miturve me të, sot është dukuri. Shënimet dhe të dhënat e sakta të organizatave, shoqatave, asociacioneve dhe institucioneve të ndryshme ndërkombëtare dhe nacionale, të cilat mirren me trajtimin dhe studimin e dukurisë së narkomanisë, flasin për numrin e madh të të miturve që kanë humbur jetën ose kanë ngelur invalid të përhershëm për shkak të përdorimit dhe varshmërisë nga droga dehëse.¹¹

Narkomania do të thotë marrje e narkotikëve të ndryshëm me ndihmën e të cilëve i mituri në mënyrë artificiale krijon disponim të këndshëm, dhe pas disponimit të këndshëm shpeshherë të gjendur në gjendje të tilla kryejnë edhe delikte të ndryshme.

Evidenca të sakta për numrin e narkomanëve të mitur në Republikën e Maqedonisë, gati se nuk ekzistojnë pasi që numri i të miturve dita më ditë ndryshon. Sipas Institutit “Shoqëria e hapur” në Maqedoni numri i narkomanëve, mendohet se është diku rreth 15-20 mijë.

2.2.1 Veçitë individuale të narkomanëve

Narkomani, si personalitet, varësisht se cilën drogë dehëse apo pije narkotike e përdor, zakonisht është personaliteti i humbur, emocionalisht i papjekur, në disa raste tepër inert, pasiv ose depresiv, e në rastet e tjera i vrazhdë apo agësiv. Këta persona pasi t’u kalojë ndikimi i efektit të drogave dehëse, lënë përshtypje të individëve që nuk kanë plane në jetë, që i kanë humbur shpresat. Këta cilësohen si persona me neuroza dhe psikopati të rënda.

Në shikim të parë, ata duken të dobët, vërehen shenja të përdorimit intravenoz të drogave të ndryshme. Vërehen edhe infeksione të lëkurës dhe sëmundje të tjera që paraqiten në këtë bazë. Shpesh infektohen edhe nga virusi HIV i cili e shkakton sëmundjen e pashërueshme AIDS. Këta persona, në veprimet dhe qëndrimet e tyre janë labilë, janë servile, të prirur të gënjejnë dhe të mashtrojnë ata mund të blihen dhe manipulohen për veprime dhe sjellje të ndryshme kriminale me doza të vogla të drogave dehëse të cilat ato i përdorin.

Për këtë arsye, këta persona, i ikin shoqërimit me personat tjerë e sidomos me persona që nuk konsumojnë drogë. Ata shoqërohen me narkomanë dhe individë të cilat janë problematikë.

Kësisojë në vendet e ndryshme të botës bashkëkohore krijohen grupe, banda dhe koloni të veçanta të narkomanëve dhe hipikëve të ndryshëm, të cilët ikin nga civilizimi, jetojnë të izoluar nëpër vende të caktuara, nuk dëshirojnë të kyçen me popullatën normale, ata paraqesin një subkulturë të veçantë.

Hulumtimet kriminologjike të grupeve të narkomanëve në disa vende të botës, vërtetojnë se këta

¹⁰ Dr.B.Tomovski,Droga sëmundje e së sotmes, Shkup ,1995,fq.10

¹¹ Prof.Dr.Ragip Halili,Kriminologjia, Prishtinë, 2005,fq,308

individë krijojnë disa rregulla, mënyra dhe zhargon të veçantë të komunikimit¹² dhe veprimet, të cilat shpeshherë bien ndesh me normat pozitive ligjore. Kësisojë flitet për një subkulturë ose nënkulturë të veçantë të narkomanëve dhe grupeve të këtilla të cilat nxisin konflikte dhe sjellje kriminale në shoqëri. Janë të njohura vrasjet dhe vetëvrasjet kolektive të grupeve dhe bandave narkomane në Amerikë, Kanadë, Zvicër etj, për shkak të normave dhe rregullave të tilla.¹³

2.2.2 Raporti i narkomanisë me kriminalitetin dhe parandalimi

Duke pasur parasysh këto rrethana, në literaturën kriminologjike, me të drejtë, narkomania trajtohet edhe si faktor kriminologjen, ngase një numër i personave, të cilët konsumojnë drogën dehëse dhe pijet tjera narkotike, jepen pas kryerjes të një varg sjelljeve delikuede dhe kriminale. Në rend të parë, shumë narkomanë mirren më veprime të ndaluara dhe kriminale.

Posaçërisht ata mirren me shitëblerjen dhe shpërndarjen e drogave dehëse dhe me nxitjen e të rinjve dhe të miturve për konsumimin e drogave dehëse . Po ashtu, individët narkomanë jepen edhe pas kryerjes së krimeve të vjedhjes, tregëtis me armë, organizimit të prostitucionit, plaçkitjes, thyerjes së dyqaneve dhe objekteve të tjera, me qëllim të sigurimit të mjeteve financiare për blerjen dhe sigurimin e drogave dehëse.

Personat narkomanë janë të kyçur edhe në krimet e dhunës, e sidomos me organizimin e prostitucionit, reketizmit, kindapimit të fëmijëve e shantazheve të ndryshme dhe shpesh marrin pjesë edhe në çrregullime të rendit publik.¹⁴

Për këtë arsye, në shumë vende janë bërë përpjekje për pengimin dhe evitimin e dukurisë së narkomanisë. Këto përpjekje kanë konsistuar në ndërmarrjen e masave për rregullimin juridik të prodhimit, shitjes dhe përdorimit të llojeve të ndryshme të drogave dehëse dhe pijeve narkotike. Nga literatura është e ditur se vendet e para të cilat kanë nxjerrë dispozita konkrete ligjore për rregullimin e prodhimit të tregëtis dhe të përdorimit të drogave dehëse e në veçanti të opiumit, konsiderohen: Franca ,SHBA-të, të cilët në këtë drejtim kanë nxjerr dekrete ligjore të veçanta. Në SHBA është i njohur Ligji mbi prodhimin dhe qarkullimin e drogës, i cili ndryshe quhet **Harison Antinarcotik akt**.

Me këtë akt, është bërë kufizimi i prodhimit, shitjes dhe importit të drogave dehëse. Në këtë drejtim posaçërisht është bërë përcaktimi i importit të drogave për nevoja shëndetësore dhe medicinale. Sipas këtij akti, punëtorët shëndetësorë, e sidomos mjekët, obligohen që substancat narkotike t'i përshkruajn si barna dhe ilaçe vetëm në raste të jashtëzakonshme , keqpërdorimet eventuale në këtë drejtim janë ndëshkuar me masa të ashpra dhe rigoroze.¹⁵

¹² D.Kozaric,K.Nenadic,T.I,jubin:Sociopatoloshka obeljezja narkomana I osoba saporemecajem licnosti Zagreb,1996, fq.18-22,23-27

¹³ St.Petrovic,vep.e cit. fq 233-234 dhe 236-237

¹⁴ Lyle.W.Shanon:Alcohol and Drugs Delinquency and Crime,London, 1998,fq.147-150, 155-163

¹⁵ I.Glick,vep e cit. fq.350-354

Më 1912, në Hagë të Holandës, miratohet edhe konventa ndërkombëtare mbi drogat dehëse. Në këtë rast, caktohen edhe definoohen substancat narkotike, si opiumi, morfiumi, kokaina, heroina etj. Po ashtu, kjo Konventë parashtroi një sërë masash për ndalimin e prodhimit dhe për shpërndarjen e drogave dehëse. Gjithashtu në këtë Konventë, kërkohet kontrollimi rigoroze , i eksportit dhe importit, përpunimi dhe disponimi ilegal i substancave narkotike. Në këtë drejtim, parashikohen edhe obligimet e veçanta të vendeve nënshkruese të kësaj konvente, për luftimin dhe ndërmarrjen e masave për pengimin e dukurisë së përhapjes së narkomanisë.

Më tej, lidhur me luftimin e narkomanisë dhe kontrollimin e drogave dehëse.

Konventa e fundit dhe e gjithëanshme konsiderohet Konventa e Vjenës, e vitit 1971 dhe kjo quhet “Konventa unike mbi substancat psikotrope”. Në këtë konventë janë caktuar se cilat substanca konsiderohen si pije narkotike si dhe është rregulluar në mënyrë të hollësishme çështja e prodhimit, vënies në qarkullim si dhe ndalimi i keqpërdorimit dhe përdorimit për nevoja medicinale. Në këtë konventë, janë paraparë edhe masat preventive dhe represive për ndalimin e keqpërdorimit të drogave dehëse.

Duhet theksuar se në Konventën e përmendur, për herë të parë është rregulluar në mënyrë konkrete organizimi në nivel ndërkombëtar i prodhimit, qarkullimit dhe vënies në përdorim të drogave dehëse dhe substancave psikotrope. Në shumë vende të botës ku narkomania si dukuri negative është në rritje, janë ndërmarrë aksione dhe veprime konkrete edhe për nxjerrjen e dispozitave dhe ligjeve të veçanta mbi rregullimin e prodhimit, qarkullimit dhe përdorimit të pijeve narkotike. Po ashtu, edhe në kodet dhe ligjet penale të shumë vendeve, janë paraparë si sjellje kriminale, një varg veprimesh lidhur me keqpërdorimin e drogave dhe substancave psikotrope.

Në disa kode penale dhe ligje penale janë paraparë si vepra penale prodhimi i substancave psikotrope dhe narkotike, shpërndarja e drogave dehëse, tregtia e pautorizuar me drogë dehëse, organizimi i rrjetit të shitësve dhe stërshitësve të drogave dehëse dhe substancave narkotike. Në disa vende, si vepër e veçantë penale është paraparë edhe nxitja dhe shtytja e personave të mitur në konsumimin e drogës dehëse, si dhe janë paraparë veprime të ndryshme lidhur me prodhimin, shitëblerjen, tregtinë dhe qarkullimin me droga dehëse, janë paraparë dënimet rigoroze, e në pjesën më të madhe edhe dënimet me vdekje.¹⁶

Mirëpo pa marrë parasysh të gjitha këto masa represive dhe dënime rigoroze e drakonike, prodhimi, qarkullimi dhe shpërndarja ilegale dhe trafikimi i drogave dehëse dhe substancave psikotrope në botën bashkëkohore, është në ekspansion. Të dhënat më të reja të statistikave kriminale tregojnë për rritjen e numrit të trafikantëve të zbuluar dhe sasinë e madhe të drogave të konfiskuara nëpër vise të ndryshme të botës.

¹⁶ R.Halili:Aspektet juridike dhe kriminologjike të alkoolizmit dhe narkomanisë. Përparimi nr.2. Prishtinë,1984,fq.177-178 dhe 183-184

2.3 NARKOMANIA DHE KRIMINALITETI

2.3.1 Kuptimi i narkomanisë dhe veçoritë kryesore

Narkomania, paraqet dukurinë negative shoqërore e cila manifestohet në përdorimin dhe konsumimin e drogave dehëse dhe pijeve të tjera narkotike. Kjo dukuri është shumë më e përhapur në botën bashkëkohore. Prania e saj në shoqërinë bashkëkohore, e sidomos marrja masovike e të miturve dhe të rinjve me të, paraqet një rrezik për mbarë shoqërinë njerëzore. Kjo dukuri sipas shumë autorëve, shkakton pasoja të rënda për shëndetin psikik dhe fizik të njeriut. Narkomania mund të sjell në pyetje jo vetëm shëndetin e individit por jetën e gjeneratave të tjera të njerëzimit.

Sipas të dhënave statistikore ndërkombëtare dhe atyre nacionale të cilat e përcjellin dukurinë e narkomanisë, sot flitet për shifra prej miliona njerëzish të cilët përdorin dhe konsumojnë drogën dehëse dhe të cilat janë bërë viktima të saj. Po ashtu qindra e miliona njerëz, në mënyra të ndryshme janë kyçur lidhur me prodhimin, shitblerjen, organizimin e rrjetit tregtar, për shpërndarjen dhe keqpërdorimin e saj për qëllimet delikuede e kriminale.

Shënimet dhe të dhënat e sakta të organizatave, shoqatave, asociacioneve dhe institucioneve të ndryshme ndërkombëtare dhe nacionale, të cilat mirren me trajtimin dhe studimin e dukurisë së narkomanisë, flasin për numrin e madh të njerëzve e sidomos të të rinjëve që kanë humbur jetën ose kan ngelur invalid të përhershëm për shkak të përdorimit dhe varshmërisë nga droga dehëse.¹⁷

Kur flitet për narkomaninë si faktor socio-patologjik në kriminologji zakonisht mendohet për të gjitha pasojat e kësaj dukurie, e në rend të parë për raportet dhe lidhjet e saj me sjelljet kriminale. Dukuria e narkomanisë mund të vështrohet dhe shikohet si problem i përdorimit dhe konsumimit të drogave dehëse dhe si varshmëri fizike dhe psikike e personave që e konsumojnë atë. Në anën tjetër, ajo mund të shikohet edhe si keqpërdorim që ka të bëjë me prodhimin, shpërndarjen ilegale dhe kundërligjore të saj.

Kërkimet e shumta të kësaj dukurie dhe të dhënat e bollëshme statistikore flasin se në botën bashkëkohore hasen në trafikimin ilegal me droga dehëse si veprimtari kriminale, ashtu edhe me konsumin dhe përdorimin e saj si problem medicinal dhe social që në mes veti janë në lidhje të ngushtë. Kjo për arsye se, pa dukurinë e konsumimit dhe përdorimit të drogës dehëse, nuk ka as prodhim, as trafik, as shpërndarje ilegale të saj e as varshmëri nga ajo.¹⁸

¹⁷ S.Stoiljkovic:Narkomanija kao socio-medicenski problem.Bcograd.1972,fq.8-10

¹⁸ S.Petrovic:Droga ljudsko ponasanje,Beograd.1983,fq.61-63

2.3.2 Nga ç'familje janë narkomanët ?

Per të gjykuar mbi familjet nga dalin përdoruesit e drogës, nuk ka statistika, as të dhëna zyrtare apo të dhëna të tjera të këtij lloji. Prandaj e vetmja mundësi mbetet analiza mbi bazën e të dhënave të anketimit.¹⁹ Ky paragraf ka, tre gjymtyrë: gjykimin mbi familjet në tërësi, pra mbi statusin social të tyre, atë mbi nivelin intelektual të familjeve si dhe analizën lidhur me nivelin ekonomik të tyre.

Mbi bazën e përgjigjeve të marra, përpiluar tre tabelat e mëposhme:

Statusi social

Në ç'familje është drogëpërdoruesi?

- Nga familje normale 73.4%
- Me prindër të divorcuar 11.7%
- Pa prindër ose me një prind 4.8%
- Me prindër të shthurur, të alkoolizuar 9.1%

Rezulton se përqindjet e përdoruesëve të drogës janë, pak a shumë, në nivelin e përqindjeve që zënë familjet e këtyre kategorive, në raport me totalin e tyre, me një prirje përkeqësimi për fëmijët që dalin nga familje me prindër të divorcuar, pa prindër ose me një prind dhe me një prirje më të theksuar kur bëhet fjalë për fëmijët me prindër të shthurur, të alkoolizuar e ca më shumë të droguar.²⁰

Motivet shtytëse drejt drogës tek ata që dalin nga familja normale mund të shpjegohen me shkaqet e përgjithëshme të fillimit të drogës nga të rinjtë. Sa për fëmijët me prindër të shthurur, të alkoolizuar e të droguar, mund të thuhet se ata janë më të predispozuarit, siç është e kuptueshme, për të hyrë në rrugën e drogës.

Niveli intelektual

Gjykimi për nga niveli intelektual:

- Me arsim të lartë 32.8%
- Me arsim të mesëm 51.7%
- Me ose pa arsim 8-vjeçar 12.6%

Lidhur me nivelin intelektual të familjeve të drogëpërdoruesve, në një nga revistat tona, nën titullin “Shqiptarët, intelektualët e drogës”, janë botuar disa të dhëna, shoqëruar me këtë shënim të redaksisë:

¹⁹ Lekë Sokoli “Droga”, shtëpia botuese Rinia 2000 . Fq. 93-98

²⁰ Lekë Sokoli “Droga”, shtëpia botuese Rinia 2000 . Fq. 93-98

Nga familje të varfëra, punëtore por edhe shumë pinjollë intelektualësh, drogaxhinjët e rinj shqiptarë për pakë vjetë kanë arritur nivelet e partnerëve të tyre në botë.

Niveli ekonomik

Gjykimi për nga niveli ekonomik

- E pasur 24.5%
- E mesme 67.4%
- E varfër 7.4%

Të dhënat mbi nivelin ekonomik të familjeve të drogëpërdoruesve , tregojnë se shumica e tyre janë nga familje të vlerësuara si mesatare. E para që bie në sy është fakti se droga nuk kursen asnjërin prej tyre.²¹ Por derisa përqindja e narkomanëve nga familje ekonomike më të pasura është në nivel 2-3 herë më të madhe se përqindja që zënë këto familje në tërësinë e familjeve shqiptare, rezulton se në to droga depërton shumë më lehtësisht.

Droga nuk i zgjedh njerëzit, nëse kanë apo nuk kanë para, por janë apo nuk janë të prirur për ta përdorur atë. Sikur njerëzit me nivel jo të mirë ekonomik të mos përdornin drogë, atëherë edhe pasojat ekonomike dhe sociale të këtij fenomeni nuk do të ishin kaq të rënda.

²¹ Lekë Sokoli “Droga”, shtëpia botuese “Rinia 2000 .

KREU III

3. VIKTIMAT E ABUZIMIT DHE VARSHMËRISË NGA SUBSTANCAT NARKOTIKE

Viktimat e konsumimit të drogave dehëse dhe substancave të ndryshme narkotike gjithashtu janë në rritje të vazhdueshme në tërë botën. Brengos fakti se si viktimat paraqiten moshat relativisht të reja të popullatës. Përdorimi i substancave të ndryshme narkotike në shumë vende fillon që nga grupmoshat më të reja, nga shkolla fillore e deri te moshat adoleshente dhe të rinjtë e tjerë. Faktorët e viktimizimit dhe varësisë nga drogat dehëse janë të mirënjohur dhe rëndom janë në ndërlidhje, të ngjyeshme me gjendjen dhe raportet familjare, problemet sociale, streset, traumat psikike e shpirtërore dhe krizat në procesin e formimit dhe edukimit të gjeratave të reja.²²

Viktimizimi nga drogat dehëse është drejtpërsëdrejti i lidhur me kontrabandimin dhe trafikimin e tyre, ngase grupeve kriminale u sjellin fitime të mëdha. Dukuria e kontrabandimit të narkomanëve është shtuar shumë kohëve të fundit. Këtë e argumentojnë edhe rastet e ndryshme të kapjes dhe zbulimit të sasive të mëdha të narkotikëve në mjedisin tonë.

Te viktimat e konsumimit të substancave narkotike vërehet varësia psikofizike, dukuria e tolerancës dhe shprehia e pasionit për të konsumuar pandërprerë.²³

Nëse shikohen disa veçori individuale të viktimave të varësis nga substancat narkotike vërehet se ato janë personalitete të humbura, emocionalisht të papjekura, tepër inerte dhe pasive, depresive, e në disa raste të vrazhda dhe agresive. Zakonisht, vuajn nga neuroza të ndryshme e në shumë raste edhe nga psikopati të rënda. Janë shëndetligë, të dobët fizikisht, në trupin e tyre, nëpër gjymtyrë vërehen gjurmë dhe shenja të infeksioneve të lëkurës apo edhe plagë të tjera nga përdorimi intravenoz i substancave të ndryshme narkotike, rëndom me shiringa apo me mjete të tjera të padezinfektuara dhe të papasta.²⁴

Këto viktimat shpesh infektohen me virusin HIV dhe ato janë popullata më e rrezikuar dhe më e sulmuar nga AIDS-i. brengos fakti se kjo kategori e viktimave nuk ka ku të shërohen apo të trajtohen, sepse mungojnë institucione për këtë qëllim.²⁵

Viktimat e drogave dehëse janë të përshtatshëm për t'u manipuluar për qëllime të ndryshme. Ato si karakter janë labil, janë servil, të prirur të gënjejnë për doza të vogla të substancave narkotike. Në kohën e krizës janë në gjendje të ndërmarrin veprime e sjellje të pamenduara dhe të kryejnë edhe krime të ndryshme. Të varurit nga substanca narkotike, për shkak të këtyre veçorive, shpeshherë jetojnë të izoluar ose jetojnë në grupe, bashkësi dhe komunitete të veçanta dhe si viktimat paraqesin një subkulturë specifike. Numri i viktimave të drogave dehëse sot paraqitet me dhjetëra apo qindra miliona në të gjithë vendet e botës.

Mbrojtja dhe ndihma e këtyre viktimave është modeste. Ato bëhen objekt interesimi dhe trajtimi, fatkeqësisht vetëm atëher kur kryejnë ndonjë vepër penale, apo kur janë të infektuara me

²² Sylen Vranica: Narkomania, Prishtinë, 1998, f.84-90

²³ A. Ramljak dhe H. Halilović: vep. e cit. f.252-255

²⁴ R. Halili, Kriminologjia, 2005, f.312-313

²⁵ F. Schmallegger vep. e cit. f.636-637, M. Demolli Narkomanët s'kanë ku të kurohen "Gazeta Lajm" 10.05.2007, f.15

virusin HIV, ose të sëmurë rëndë nga AIDS-i. Mjerisht, në shumë vende, por edhe në vendin tonë, mungojnë institucione të specializuara për trajtimin, shërimin dhe ndihmën profesionale, materiale dhe morale të viktimave të narkomanisë apo të varësisë nga substancat narkotike.²⁶

3.1.Përkufizimet e narkotikëve dhe substancave psikotrope

Narkotikët dhe substancat psikotrope janë të gjitha kimikatet që kanë efekt në trupin dhe mendjen e njeriut. Përdorimi i tyre mund të çojë në varësinë fizike dhe psikologjike. Zakonisht në punimet shkencore narkotikët dallohen prej substancave psikotrope sepse i referohen alkaloidëve me opium, por për qëllime forenzike termi “DROG” mund të përdoret për të definuar të gjitha substancat me të cilat mund të abuzohet.

3.2 Historia e Narkotikëve

Historia e drogës është e vjetër sa edhe raca njerëzore. Drogat natyrore janë përdorur nga njerëz të lashtë të mjekësisë për të shëruar sëmundje pa marrë parasysh efektet anësore. Shkenctarët dhe mjekët sot, konstatojnë se nuk ka asnjë medikament që nuk është i dëmshëm ose helmues nëse merret në sasi të mëdha, prandaj shumica e punimeve shkencore mbi drogat kanë të bëjnë me përpjekjet për të zgjidhur hendekun mes dozave efektive dhe toksike. Që nga kohët e lashta drogat janë përgatitur nga bimë dhe janë përdorur për trajtimin e sëmundjeve të ndryshme.

Sumerianët ishin një nga shoqëritë më të hershme urbane në botë, në jug të Mesopotamisë më shumë se 5000 vjet më parë të cilët përdornin opiumin si qetësues. Meksikanët pra Kolumbia përdornin shumë substanca nga duhani për qëllim të trajtimeve medikale dhe ceremonive fetare, kanabisi, opiumi, koka, bush dhe droga të tjera me prejardhje bimore janë përdorur në forma të ndryshme.

Me fjalë të tjera historia e drogave gjithmonë ka qenë pjesë esenciale e kulturave dhe religjioneve rituale gjatë historisë. Në shumicën e rasteve, drogat të cilat janë konsideruar të pranueshme nga shoqëria, me vonë janë ndaluar dhe përdorimi i tyre është konsideruar si ilegal. Shembull i këtyre drogave janë Opiatet dhe Kokaina të cilat në mënyre gjenerale janë konsideruar si substanca të pranueshme deri në shekullin XIX dhe zakonisht janë përdorur si për qëllime medikale po ashtu edhe jo medikale.

Sidoqoftë përdorimi jo medikal i këtyre drogave u bë ilegal në shekullin XX.

²⁶ F.Schmallegger vep.e cit,f.636-637, M.Demolli Narkomanët s'kanë ku të kurohen “Gazeta Lajm”10.05.2007

3.3 Veprat lidhur me narkotikët dhe substancat psikotrope

Ç'ështëja e narkomanisë sot, si dukuri socio-patologjike paraqet problem aktual në botë. Narkomania si dukuri shumë e rrezikëshme shoqërore përpos që është bërë problem ndërkombëtar, ku janë miratuar shumë konventa ndërkombëtare për luftimin e të njejtës, poashtu edhe legjislacionet e shteteve kanë paraparë inkriminime kundër prodhimit, transportit dhe vënies në qarkullim në mënyrë të pautorizuar të narkotikëve. Këtë veprë penale e kryen kushdo që në mënyrë të pa autorizuar prodhon, shet apo ofron në shitje, apo në mënyrë tjetër të pa autorizuar lëshon në qarkullim narkotikë dhe substanca narkotike. Objekti i mbrojtjes së kësaj vepre penale është shëndeti i njerëzve.

Lidhur me fajësin, kjo veprë penale mund të kryhet vetëm me dashje e cila duhet të përfshijë në vete edhe vetëdijen e kryerësit të veprës për figurën e veprës penale. Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person. Për këtë formë të veprës penale është paraparë dënimi me burgim prej 1 deri në 10 vjet. Forma më e rëndë e kësaj vepre penale është kryer kur në kryerjen e veprës penale kanë marrë pjesë më shumë persona apo nëse kryerësi ka krijuar rrjetin e stërshitësve apo ndërmjetësuesve dhe për këtë formë të veprës është paraparë dënim me burgim së paku 5 vjet.

Forma tjetër e kësaj vepre penale e cila konsiderohet se kryhet në rastet kur ndokush i mundëson personit tjetër apo i krijon kushte për përdorim të drogave narkotike apo substancave psikotrope, me çka do të dënohet me dënim me burgim deri në 5 vjet.

Ndërkaq, nëse vepra është kryer ndaj personave të mitur apo ndaj më shumë personave, kryerësi do të dënohet me dënim me burgim deri në 10 vjet.²⁷

²⁷ Prof.dr.Ragip Halili,pjesa e posacme e të drejtës penale,fq.101-102

KREU IV

4. Ç'ËSHTE DROGA?

Droga është një substancë me origjinë bimore ose kimikisht të sintetizuar, që përdoret si narkotik. Me të lidhen fjalët narko, një rrënjë që nënkupton gjumë ose tregon relacione me të gjëra , narkotik (gr.narkotikos), që do të thotë përgjum, mpin, ngathtëson, narkozë dhe narkomani (gr. Narko-dehem +mani-tërbim).²⁸

Në gjuhën e përditshme fjala drogë nënkupton një zinxhir realitetesh dramatike, një sëmundje apo mani me pasoja vetjake e sociale, shpesh të pariparueshme, si dhe produkte, përdorimi i të cilave është i ndaluar me ligj.

Mund të përkufizojmë: Droga është agjent i destinuar për të dhënë efektet psikike të dëshiruara e të këndshme, nganjëherë edhe të nevojshme, por që përdorimi i tij mbart rrezikun e abuzimit, të varësisë së përdoruesit prej saj, të tolerancës dhe të shumë pasojave të tjera negative vetjake e sociale.



Fig.2. Ndal droga vret.

4.1 LLojet e drogave dehëse, klasifikimi dhe substancat narkotike

Me qëllim të njohjes më të plotë të kësaj dukuri, do t'i përmendim disa nga drogat dehëse dhe pijet më të njohura narkotike. Duhet theksuar se të gjitha drogat dehëse dhe pijet narkotike hyjnë në radhën e materjeve toksike dhe helmuese, kështu që, shpeshherë kjo gjendje e përdorimit dhe varshmërisë nga droga quhet gjendje e **helmimit ose toksikomanisë**. Ndërsa vetë konsumuesi, shpeshëherë quhet toksikoman.

Të gjitha drogat dehëse ose pijet narkotike për kah origjina mund të jenë: **natyrore dhe sintetike**. **Natyrore** janë ato droga dehëse dhe pije narkotike që gjenden në natyrë, që merren drejtpërdrejt nga natyra, ndërsa droga dehëse apo pije **narkotike sintetike** janë ato të cilat prodhohen në

²⁸ Lekë Sokoli "Droga", shtëpia botuese "Rinia 2000" fq.17

mënyrë artificiale. Në konventat ndërkombëtare dhe në dokumentet e tjera të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe të organizatave e asociacioneve të tjera që rregullojnë këtë lëmi, janë caktuar kriteret për caktimin e llojeve dhe klasifikimin e drogave dehëse. Sipas këtyre klasifikimeve, të gjitha drogat dehëse dhe pijet narkotike ndahen në: narkotikë, substanca psikotrope apo depresante, pije simuluese dhe pije narkohalucinogjene. Në radhën e drogave dehëse dhe substancave narkotike më të njohura bëjnë pjesë: **opiumi, morfina, heroina, kokaina, marihuana, fleta kanabis, hashishi, meskalina, amfetamina** etj.²⁹

Shkenctari i njohur Levin, bënë një klasifikimin të drogave dehëse dhe pijeve narkotike, varësisht se çfarë efekti shkaktojnë ato te individët të cilët i përdorin. Kësisoj, ai flet për drogat dehëse **“euforika”** të cilat kanë efekte të qetësimit dhe shkaktojnë **“kënaqësi të shpirtit dhe trupit”**. Droga të tilla sipas tij, janë opiumi dhe alkooloidët e tij, kokaina etj. Drogat e tjera dehëse sipas tij paraqesin grupin e drogave që ai e quan **“hipnotika”** e të cilat kanë efekte të atilla që individët i vejnë në gjumë. Të tilla janë barbituratet e ndryshme.

Ndarja tjetër është, ndarja në droga që ai i quan **“inebriantia”** të cilët kanë efekte të depresionit, të tilla janë kloroformi, eteri, etj.

Levini edhe më tej përmend edhe grupin e drogave dehëse të cilat ai e emërton me **“fantastika”** të cilat sipas tij, shkaktojnë halucinacione dhe iluzione te personat që i përdorin drogat e tilla. Si droga të tilla janë: **meskalini, LSD, hashishi, marihuana** etj.

Grupin e fundit të drogave dehëse, sipas këtij autori, e përbëjnë të ashtuquajturat droga **“ekstancia”**, të cilat nxisin dhe stimulojnë personat e caktuar në aktivitete të ndryshme. Të tilla sipas tij, janë: **kofeina, amfitamina, fenotrazina, netoamfimina** etj.³⁰

Ndër pijet tjera psikotrope përmenden edhe pijet të cilat zgjojnë **halucinacione** dhe gjendje tjera **joreale** te individë të cilët i konsumojnë. Si të tilla konsiderohen **marihuana, LSD, meskalini, etj.** Karakteristikë e këtyre drogave dehëse apo pijeve narkotike është se konsumuesi ndryshon krejtësisht si personalitet. Te ai vërehen ndryshimet e raporteve ndaj rrethit shoqëror. Individët e tillë humbin ndjenjën e realitetit. Sistemi i tyre nervor qëndror ndërron në atë masë se ata jetojnë në një botë të imagjinuar, në një botë fantastike, ireale, në një botë ëndrrash. Zakonisht, këto droga dehëse i përdorin dhe konsumojnë personat të cilët përpiqen që duke ikur nga kushtet e caktuara jetësore dhe ekonomike material për një kohë të jetojnë në iluzione dhe në botën e ëndërrave. Gjendja e kështillë te këta individë përkohësisht krijon njëfarë përshtypje se ata janë plotësisht të lirë.

Se nuk janë të ngarkuar me kurrfarë problemesh, se i kanë zgjidhur të gjitha çështjet dhe problemet jetësore. Mirpo, kjo është përshtypje e rrejshme, e përkohshme, sepse pas pushimit të efektit të këtyre pijeve narkotike sërish gjenden para realitetit objektiv. Për këtë arsye, këta persona, pesh bien në gjendje të vështira psikike dhe shpirtërore, pësojnë trauma dhe konflikte me vetveten por edhe me rrethin.

²⁹ M.Nicovic: Opojne droge multinacionalna kompanija kriminala, Zagreb.1989, fq.9-10

³⁰ Z.Shita: Aspekti psikiatrik i toksimanive, botuar në Problemi shoqëror i alkoolizmit dhe narkomanisë në Kosovë, Prishtinë, 1984, fq.49-50

Këta persona, kur janë në gjendje të ndikimit dhe veprimit të pijeve të këtitlla narkotike, mund të jepen edhe pas sjelljeve dhe veprimeve të pakontrolluara dhe të ndërmarrin akte të rrezikshme. Sipas konstatimit të kriminologut gjerman **Schwind** nga helmimi me droge numri i viktimave është në rritje në Gjermani. Ata shpeshherë në këtë gjendje kanë përshtypje të rrejshme se mund të fluturojnë, se mund të hidhen prej lartësive të mëdha, se mund të kapërcejnë objekte dhe pengesa të ndryshme, të cilat siç shihet mund t'i fusin në veprime e sjellje kriminale të rënda e tragjike.³¹

Lidhur me narkomanët, theksohet se vërehet dëshira dhe nevoja e papërballueshme dhe e vazhdueshme për përdorimin dhe konsumimin e drogave dehëse dhe pijeve narkotike. Karakteristikë e mëtejme e personave të cilët konsumojnë drogat dehëse, është se nuk zgjedhin mjete dhe metoda, që t'i sigurojnë pijet narkotike. Gjithashtu te këto vrehet tendenca e shtimit të dozave të përdorimit ditor, dhe varshmëria permanente fizike dhe psikike nga këto pije narkotike. Përdorimi i vazhdueshëm i drogave dehëse dhe pijeve narkotike, te këta persona krijon një shprehi, një pasion, një ndjenjë sipas së cilës ata nuk mund të jetojnë dhe të ndërmarrin asnjë aktivitet në jetën e tyre pa konsumimin e dozave të caktuara të pijeve narkotike.³²

Sipas Organizates Boterore te Shendetesise drogat i klasifikojme ne tre grupe:

- Stimulantet;
- Halucinogjenet;
- Depresantet.

Stimulantet- quhen ndryshe edhe drogat eksituese. Në këtë kategori perfshihet: kokaina, atropina, amfetamina, kafeina, teina, nikotina. Stimulantet kane efekte eksituese tek personat që i perdorin ato. Drogat stimuluese shpejtojnë funksionet e organizmit. Si rrjedhim personi që merr stimulantin ndjehet më i gjallë, i vëmendshëm dhe i sigurt tek vetja.³³ Ato rritin rrahjet e zemrës, temperaturën e trupit dhe tensionin e gjakut. Stimulantët pakësojnë oreksin, zmadhojnë pupilat e syrit, sjellin pagjumësi dhe e bëjnë përdoruesin që të flasë pa pushim apo të jetë pak nervoz. Marrja e sasive të mëdha të stimulatëve shkakton ankth, panik, kriza, dhimbje koke, dhimbje në stomak, agresivitet dhe paranojë. Stimulantët e fortë mund të maskojnë disa nga efektet e depresantëve si për shëmbull alkooli. Kemi :

³¹ H.D.Schwind,vep e cit,fq,526-528

³² I.J.Siegel.vep.e cit.fq.364-366 dhe 367-369

³³ Po aty.

Stimulantët e lehtë

- Kafeina (në çaj, kafe dhe pijet me kola)
- Nikotina (duhani)
- Efedrina (përdoret në mjekimet për bronkitin, alergjinë e pranverës dhe astmën)

Stimulantët e fortë

- Amfitaminat (“speed”, “crystal meth”, “ice”)
- Kokaina
- Ekstazia
- Tabletat dobësuese (Duromine, Tenuate Dospan, Ponderaks)
- Khat

- Nga drogat e llojit stimulant më kryesorja është kokaina. **Kokaina**- Ajo prodhohet nga bima “koka”. Efektet e kokainës janë cilësisht të ndryshme nga depresantet si heroina, opiumi, morfina. Njeriu që ka marrë kokaine është euforik, impulsiv, energjik dhe orator. Një pjesë e kokainës shndërrohet në "krak", substancë që mund të pihet si duhan. Kjo ka një efekt më të shpejtë se kokaina, ndonëse efekti zgjat më pak si kohë. Në kuadrin e një 10-vjeçari, degradimi i njeriut që përdor këtë drogë është shumë i madh. Ai ka një organizëm të lodhur, një lëkurë tejet të verdhë, ndihet i dobësuar dhe pa asnjë shpresë për jetën. Përdorimi i saj është veçmas i pranishëm në disa qarqe kulturore artistike, në qarqet e rok dhe pop muzikës. Kjo përdoret për “inspirime”, si simulim për punë “krijuese”, për “shtimin” e aftësis dhe mundësisë së marrjes me profesione dhe mjeshtëri të caktuara. Flitet se këtë drogë dehëse, përveç të rinjve e përdorin edhe shumë individë të cilët merrren me shkrime, me hulumtime shkencore, artist dhe këngëtar të ndryshëm, me qëllim të forcimit dhe arritjes së rezultateve më të mira në fushat me të cilat merren.



Fig.3. Marrja e kokainës

Nga këto pije, zakonisht prodhohen edhe mjete të ashtuquajtura **doping**, për sportistë të njohur, për arritjen e rezultateve kulminative. Mirëpo, në jetën e përditshme ky stimuli është i përkohshëm, i rrejshëm dhe paraqet një farë iluzioni, sepse posa të bjerë efekti i drogës dehëse, individit pa marrë parasysh se me çfarë pune dhe aktiviteti merret, kthehet në një gjendje të dëshpërimit, në një gjendje pasive. E kaplon anemia dhe mungesa e dëshirës për punë dhe jetë. Shpeshherë, këta individ të profileve të ndryshme, përjetojnë çrregullime të rënda shpirtërore, jepen pasë sjelljeve delikuede dhe kriminale dhe nuk janë të rralla rastet e vetëvrasjeve dhe mbarimit tragjik të jetës së tyre. Dihet se në lëmin e sportit dhe garave sportive, kur zbulohen personat e tillë të cilët kanë konsumuar ose kanë përdorur mjete stimululave, diskualifikohen rezultatet e arritura nuk pranohen dhe në këtë mënyrë, shpeshherë këta individë për shkak të dëshpërimit që pësojnë, fillojnë të merren më sjellje dhe veprime delikuede.

Haluçinogjenet- Drogat haluçinogjene shëndrrojnë mënyrën se si një person sheh ose imagjimon atë që e rrethon. Personat që marrin haluçinogjene mund të shohin apo dëgjojnë gjëra që nuk egzistojnë, ose mund të shohin gjëra të tjetërsuara.³⁴

Efekte të tjera të haluçinogjenëve janë zmadhim i pilulave të syrit, ikja e oreksit, rritja e lëvizjeve, të folura dhe të qeshura të tepruara, eufori emocionale dhe psikologjike, shtrëngim të nofullave, panik, djersitje, paranojë, humbje të kontaktit me realitetin, sjellje të çuditshme dhe të paarsyeshme, dhimbje në stomak dhe përzierje.

Meqenëse efektet e haluçinogjenëve janë të ndryshme është e pamundur që të parashikohet se si ata mund të ndikojnë tek njeri apo tek tjetri në një kohë të caktuar.

Nga haluçinogjenet mund të përmendim: kanabisin, L.S.D, etj.

- Nga **kanabisi** prodhohet hashashi, marihuana dhe ekstrakte kanabisi. Hashashi vjen nga frutet e kanabist, ndërsa marihuana edhe nga perzierje gjethesh, lulësh dhe farëra të saj.

Kanabisi është një lëndë si duhani, me ngjyrë mes të gjelbrës dhe kafesë e cila përbëhet nga lulet dhe gjethet e sipërme të thara të bimës së kërpit. Rrëshira e kanabisit apo siç quhet ndryshe, hashashi,³⁵ është mbetja e tharë e një lëndë që nxirret nga pjesa e sipërme e lulëzuar e bimës së kërpit, e cila kthehet në pluhur.

Vaji i kanabisit ose ndryshe, vaji i hashashit, është një lëng i cili nxirret ose nga bima e tharë ose nga rrëshira.

Si merret?- Zakonisht, të gjitha format e kanabisit merren përmes tymosjes, si duhani. Rrëshira dhe vaji i kanabisit mund edhe të hahen ose të pihen në formën e çajit.

Çfar ndikimi ka te përdoruesi?- Kanabisi i jep përdoruesit një ndjesi relaksimi dhe kënaqësie dhe ndonjëherë vendos në një gjendje euforije.³⁶ Përdoruesi mund të përvoj edhe një ndjesi më të fortë të shqisave të shikimit, nuhatjes, shijes dhe dëgjimit.

³⁴ Po aty.

³⁵ <http://www.slideshare.net/ermaltroksi/projekt-droga>

³⁶ <http://www.slideshare.net/ermaltroksi/projekt-droga>

Cilat janë rreziqet që lidhen me përdorimin e kanabisit?- Në periudhën afatshkurtër përdoruesit i rritet oreksi dhe pulsi.³⁷ Përdoruesi ka problem edhe me kryerjen e akteve fizike dhe intelektuale, si për shembull e ka të vështirë të ngas makinën apo të mendojë në mënyrë logjike. Nëse merret në doza të mëdha, kanabisi mund të mprehtë preceptimin e tingujve dhe të ngjyrave nga ana e përdoruesit, ndërkohë që ia bën të ngadaltë dhe të paqartë të menduarit. Nëse doza është shumë e madhe, efekti i kanabisit është i ngajshëm me efektin e drogave dhe halucinogjeneve dhe mund të shkaktojë ankth, panik dhe madje episode psikopatie. Përdoruesit e rregulltë të kanabisit përballen me rrezikun e zhvillimit të një varësie psikologjike deri në atë masë sat ë humbasin interesin në të gjitha aktivitetet e tjera si puna apo marrdhëniet me njerëzit.

Kanabisi ka nivelin më të lartë të konsumit në botë. Ajo është e vetmja bimë që rritet në Shqipëri. Sot ajo kultivohet në të gjitha kontinentet. Territoret ku kultivohet më tepër janë: India, Afrika e Veriut dhe Amerika Qendrore. Kjo lloj droge vepron në kontekstin e trurit³⁸. Shpeshherë përdoruesi paraqet sjellje impulsive dhe agresive.

- **L.S.D është shkurtimi i emrit Lusergic Dietylomid Saure-** LSD-ja është gjysmë-sintetike e prodhuar nga acidi lisergjik , i cili gjendet në një përpudhë që rritet në bimën e thekrës dhe drithëra të tjera. LSD-ja, e cila zakonisht quhet edhe “acidi”, është një prej drogave halucinogjene më të fuqishme.³⁹ Në rrugë zakonisht shitet në formën e katrorëve të vegjël prej letre me flluska me kokrra ku brenda përmbahet droga, por shitet edhe në formën e tabletave, kapsulave si dhe në formë të lëngshme. Është një lëndë pa ngjyrë dhe pa erë, me një shije paksa të hidhur.

Si merret?- Zakonisht gëlltitet.

Çfarë ndikimi ka te përdoruesit?- Nëse merret LSD, ajo shkakton ndryshime të forta në mendime, humor dhe shqisa, krahas ndjenjave të afërsisë dhe shoqërimit. Megjithatë, efektet e sakta të LSD-së ndryshojnë në varësi të gjendjes mendore të përdoruesit dhe mjedisit ku merret kjo drogë.

Në periudhën afatshkurtër, LSD-ja shkakton zhgënjim dhe preceptime të shtrembëruara. Ndryshon sensi i thellësisë dhe kohës së përdoruesit, ndërsa bëhen më të mprehta ngjyrat, tingujt dhe prekja.⁴⁰ Disa përdorues të LSD-së provojnë mendime dhe ndjenja të forta dhe të frikshme si për shembull frika se mos humbasin kontrollin, frika nga çmenduri, vdekja dhe dëshpërim. Pasojat fizike janë të vogla në krahasim me pasojat psikologjike dhe emocionale. Në të përfshihet zmadhimi i bebes së syrit, shpeshtimi i rrahjeve të zëmrës, rritja e tensionit të gjakut, humbja e oreksit, pagjumësia, thatësi në gojë dhe të dridhura.

³⁷ <http://www.slideshare.net/ermaltroksi/projekt-droga>

³⁸ Nj. Shtino “Psikiatria Ligjore”, 2005, fq. 193.

³⁹ <http://www.slideshare.net/ermaltroksi/projekt-droga>

⁴⁰ <http://www.slideshare.net/ermaltroksi/projekt-droga>

LSD-ja është zbuluar nga kimistët gjerman Stoll dhe Hofman si preparat tek acidi liserxhik. Fillimisht kjo lloj droge pati përhapje tek konsumuesit, por aktualisht është kufizuar ndjeshëm sepse jep deformime tek fëmijët kur nëna është konsumatore e saj.

Depresantet—në këtë grup bëjnë pjesë droga me veprim në sistemin nervor qendror, që kanë efekte qetësuese ose gjumëdhënëse. Depresantët janë droga që ngadalësojnë funksionin e trupit duke përfshirë edhe mesazhet për nga truri. Ato ndikojnë në përqëndrimin dhe kordinimin dhe ngadalësojnë aftësinë për t'ju përgjigjur situatave të papritura. Në sasi të mëdha mund të shkaktojnë humbje të vetëdijes, të vjella e deri në vdekje.

Tek depresantët përfshihen drogat me permbajtje opiumi si: opiumi, morfina dhe heroina.

- **Opiumi** -nxirret nga përpunimi i lulëkuqes. Opiumi merret nga prerja e kapsulave të papjekura të lulëkuqeve në formë të qumështit “latex” i njohur si opiumi i papërpunuar. Përbërësit kryesor të opiumit të papërpunuar janë: fragmente bimore, rrëshirë, alkoole triterpenoide, acide yndyrore, polisakaride dhe më shumë se tridhjetë alkaloidë. Këto alkaloidë janë të ndarë në dy klasa: kimike, alkaloid. Vendet kryesore prodhuese të tij janë: India, Kina, Afganistani, Turqia, Egjypti, Meksika, etj. Vetia kryesore psiko-fiziologjike e opiumit është se vepron si ligështues i sistemit të lartë nervor, shkakton një gjendje euforie e shoqëruar me dremitje dhe ëndërra. Pihet me pipa të posaçme si duhan ose mund të gëlltitet si pije apo në formë pilulash.



Fig.4.Si duket opiumi

- **Morfina** është pije narkotike që aplikohet në shëndetësi e mjekësi dhe në shumë raste ndodh që të keqpërdoret. Morfina në gjendje të pastër, duket si një pluhur i bardhë dhe përfitohet nga opiumi. Konsimimi i tij nxit dhe shkakton një disponim e eufori te individët të cilët e përdorin. Në medicinë dhe shëndetësi, u jepen personave të cilët vuajnë prej smundjeve të rënda dhe të cilët ndiejnë dhembje të padurueshme fizike. Morfina, ndikon që dhëmbjet e tilla të zvoglohen ose të eliminohen përkohësisht. Këta persona, zakonisht pas shërimit nga sëmundjet dhe dhembjet e tilla , shpeshherë shndërrohen në narkomanë, sepse organizmi i tyre ka krijuar varshmëri nga konsumimi dhe përdorimi i drogës së tillë.

Morfinën e përdorin edhe personat të cilët nuk vuajnë prej sëmundjeve të ndryshme por të cilët dëshirojnë për disa çaste t'i "harrojnë" brengat dhe të gjenden në një botë "pa probleme".⁴¹

Morfina është alkaloid kryesor i opiumit, pjesëmarrja e së cilës sillet prej e 4-21% .Ajo është një nga drogat më të efektshme të njohura për lehtësim të dhimbjeve. Klinikisht ajo përdoret vetëm në raste absolutisht të nevojshme, për shkak të varësisë që mund të krijoj.Morfina e papërpunuar në tregun e paligjshëm mund të jetë e cilësisë së lartë ose të ulët,varësisht nga procedurat e pastrimit, qëllimi i synuar, njohurit dhe aftësitë profesionale të prodhuesit të paligjshëm.

Produkti përfundimtar i morfinës që qarkullon në tregun ilegal zakonisht përmban edhe primesa tjera si :Kodeinë, Tebainë,Noskapiinë dhe Papaverinë si papastërti.



Fig.5.Si duket morfina

- **Heroina-** është derivate i morfiumit dhe bënë pjesë në drogat helmuese ose toksikomane,ose në toksikomani të rëndë. Është konstatim i përgjithshëm se heroina është pija narkotike më e përhapur në botën bashkëkohore. Ajo është një drogë e fortë përkahe efektet dhe për këtë arsye, e ka marrë edhe emrin simbolik **heroinë**. Kjo është drogë stimuluese.Heroina është drogë e rëndë. Heroina është pikërisht shkalla e fundit e këtij procesi. Zakonisht shpimi i parë shkakton ankth, dridhje, të përziera e të vjella. Efekti i kënaqësis e pushon trupin, arrihet zakonisht pas shpimit të tretë. Sukesit i saj lidhet me faktin se ajo qetëson, të zhyt në një botë të qetë, rrit besimin e përdoruesit ndaj vetes, krijon një gjendje tërësisht euforike, pra jep humor të mirë. Por ajo provokon pagjumësi, përzierje e të vjella. Këta reaksione, që nisin fill pas injeksionit, zgjasin deri në 6 orë. Shkalla e intoksimit të heroina është shumë më e madhe nga ajo e drogave të tjera të të njëjtit grup. Heroina është droga më skllavëruese.

⁴¹ S.Vranica:Narkomania, Prishtinë,1998 fq 18-25 dhe31-40

Ndryshe nga kokaina(edhe ajo drogë e fortë, por që jep varësi jo shumë të madhe fizike), te heroina varësia fizike shfaqet thuajse menjëherë.

Por sapo arrihet gjendja e varësisë, fillojnë të shfaqen edhe shenjat e para të shqetësimeve në nivel fizik: ritmi i gjumit prishet, humbet oreksi, dhëmbët fillojnë të krimben dhe të bien,ulet niveli i mbrojtjes imunitare. Kalimet nga euforia te depresioni përsëriten shumë herë gjatë ditës. Heroina ka një forcë të jashtëzakonshme tërheqëse. Ajo të tjetëron. Sapo kthehesh në gjendje normale, mendja të shkon prap atje. Për arsye, shumica e të droguarve përpiqen të ulin sasinë e drogës ose të heqin dorë prej saj. Por kjo është tepër e vështirë sepse heroina ka një krizë të thekësuar abstinence (kriza e mungesës). Heroina e pastër është pluhur i bardhë me shije të hidhur. Pjesa më e madhe e heroinës së paligjshme është në formë pluhuri dhe mund të ndryshoj ngjyrën nga e bardhë në ngjyrë kafe të errët për shkak të papastërtive të cilat mbesin gjatë procesit të prodhimit apo nga prania e aditivëve si dhe agjentëve hollues si sheqerna, niseshte, qumësht pluhur dhe kininës. Heroina është një qetësues dhe shkakton një ndjenjë euforike, të përgjumur dhe të ngrohtë ajo gjithashtu heq stresin, duke krijuar një shkëputje të relaksuar nga dhimbjet dhe dëshirat.



Fig.5. Përgatitja e heroinës

Substancat narkotike dhe drogat dehëse, për shkak të cilësive të veta kimike dhe fizike, ndikojnë dukshëm në shëndetin psikik dhe fizik të personave që janë të varur nga ato. Te disa individë, në këtë drejtim, pason shkatërrimi i sistemit nervor, çrregullimi i qendrave vitale dhe organeve kryesore, si: dobësimi i zemrës, sëmundjet e veshkëve, shkatërrimi i mëlçisë etj. Shumë prej tyre vdesin në mundime të mëdha ose ngelin invalid të përhershëm. Këtë e vërtetojnë të dhënat mbi numrin e viktimave nga droga në disa shtete. Është karakteristike se në pikpamje morale dhe shoqërore, personat të cilët konsumojnë drogën

dhe janë bërë të varur nga ajo, në pikpamje morale dhe shoqërore, shpejt degradohen, humbin autoritetin, si në familje ashtu edhe në rrethin e ngushtë shoqëror. Familjet dhe antarët e tyre të cilët konsumojn drogën, shpeshherë në mënyrë kronike pësojnë trauma dhe tronditje të mëdha. Këto familje shkapërderdhen e dezorganizohen, pastaj ndodh shkurorëzimi dhe braktisja e antarëve të këtyre familjeve e më në fund edhe marrja me veprime kriminale.⁴²

Me drogë abusive⁴³ kuptojmë çfarëdo substancë, e marrë në cilëndo formë të mundshme turbullon humorin, nivelin e perceptimit dhe funksionin cerebral. Sipas këtij përkufizimi merren parasysh drogat e ligjshme, si duhani apo alkooli, si dhe ato të paligjshmet: hashashi, heroina, kokaina, drogat sintetike, etj

Droga është një substancë që sjell ndryshime fizike dhe psikologjike.

Droga mund të jetë e ngurtë (krak), e lëngshme (alkooli), ose e gaztë (inhalante).

Pavarësisht nga drogat e përdorura të gjitha janë të dëmshme dhe kanë efekte tek përdoruesit e më tej. Përdorimi i drogës ndikon tek shëndeti, puna, jeta personale, në familje dhe në rrethin shoqëror.

Njerezit mund të përdorin drogat:

- Për të ndryshuar mënyrën sesi ndjehen sepse duan që të ndjehen më mirë ose thjesht ndryshe;
- Sepse besojnë në dobishmërinë e tyre;
- Për t'u çlodhur;
- Për t'u argëtuar;
- Për t'u bërë pjesë e shoqërisë;
- Për shkak të kureshtjes;
- Për të lehtësuar apo minimizuar dhimbjen fizike dhe psikologjike.

4.1.1 Përdorimi dhe përdorimi abuziv

Është shumë e vështirë, në mos e mundur, që droga të përdoret në parametra normal. Ajo mbart rrezikun e abuzimit, aq sa shpesh në vend të vetë fjalës drogë përdoret fjala substancë abuzimi. Atëhere, ç' është abuzimi?⁴⁴

Abuzimi është një përdorim i tepruar, i rrezikshëm dhe i ndaluar i drogës. Por jo çdo përdorim droge përfaqëson abuzim. Thënë ndryshe, cili është përdorimi normal, përtej të cilit fillon teprimi ose abuzimi? Në shumicën e rasteve ky kufi është thjeshtë individual. Psh. Në rastin e morfinës ai përdoret pa dëmtuar atë që e përdor nga ajo që shkakton dehje dhe alkoolizim. Në përdorimin e drogave të tjera ky kufi është i paqartë ose inekzistent.

⁴² S.Vranica vep. E cit..fq 135-145

⁴³ http://www.ishp.gov.al/multimedia/botime/broshure_droga.pdf

⁴⁴ Lekë Sokoli "Droga", shtëpia botuese "Rinia 2000" fq.18

Është e pamundur të përcaktohen kritere rigoroze në zgjedhjen e tipit të drogës sipas veçorive individuale të përdoruesve. Për këtë arsye e njejta drogë, e përdorur në të njëjtën sasi, te dy individë mund të japë nivele të ndryshme kënaqësie. Po ashtu, nëse tek i pari mund të shkaktojë anomali të vogla, të dytit mund t'i shkaktojë edhe vdekjen.

4.1.2 Varësia nga droga dhe toksikomania

Nga përdorimi i përsëritur i një droge, një njeri mund të bëhet i varur psikologjikisht dhe fiziologjikisht prej saj.⁴⁵ Koncepti i varësisë nga droga është relativisht i ri. Deri në vitin 1965 studiuesit parapëlqenin të flisnin për toksikomani. Në gjykimin e tyre kjo përbënte formën më të theksuar të skllavërisë ndaj drogës, ose një shtysë të brendshme të njeriut drejtë drogës. Toksikomania është një gjendje intoksimi periodik ose kronik, që shkaktohet nga konsumimi i drogave natyrore dhe sintetike.

Disa nga karakteristikat bazë që dallojnë këtë fenomen janë:

- Një dëshirë e papërmbajtur, nevojë për konsumimin e drogës, duke e siguruar atë me çdo lloj mjeti;
- Prirja e rritjes së dozës së përdorur;
- Varësi e natyrës psikike (psikologjike) dhe shpesh edhe fizike përkundrejt efektit të vetë drogës;
- Efekte të rënda sekondare (pasoja) për individin e veçantë dhe për shoqërinë.

Në studimet e mëvonshme u theksua fakti se midis individit dhe drogës vendoset një raport varësie. Intensiteti dhe mënyrat që e karakterizojnë atë luhaten në funksion të substancës së dhënë dhe individit që e përdor atë.

Por ç'është kjo varësi?

Varësia nga droga është një nevojë e pafrenuar dhe e ndërgjegjshme për të përdorur drogë, tashmë jo vetëm për të riprodhuar efektet e fillimit, por për të mënjанuar shqetësimet e shkaktuara nga mungesa e saj. Jo të gjitha drogat shkaktojnë një varësi të tillë. Përgjithësisht varësia manifestohet pas njëfarë stazhi kohëpërdorimi.

Ky kushtëzim lidhet me një tërësi faktorësh e veçorish fiziologjike, të cilat nga njëra anë kundërbalancojnë efektet e drogës por, nga ana tjetër, çojnë në një ekuilibër të ri biologjik i cili për t'u mbajtur kërkon përsëri praninë e drogës.

Varësia mund të jetë psikologjike dhe fizike. Te një person është shfaqur varësia psikologjike kur ai e dëshiron fort një drogë, ndonëse ajo ende nuk i nevojitet biologjikisht organizmit. Ajo

⁴⁵ Lekë Sokoli "Droga", shtëpia botuese "Rinia 2000" Fq.18

lidhet me të mësuarit, se efekti i drogës është i këndshëm dhe se ajo ndihmon për përballimin e problemeve. Është i njohur parimi social-psikologjik sipas të cilit veprimet që sjellin kënaqësi kanë prirjen të përsëriten.

Disa droga shkaktojnë varësi fizike, e cila përfaqëson një gjendje në të cilën trupi i përdoruesit të rregullt bëhet biokimisht i varur nga drogat. Në këto raste mund të thuhet se droga është shndërruar në një nevojë organike, domethënë trupi, duke përfshirë edhe sistemin nervor qendror, përshtatet dhe jep produktivitet, pra funksionin vetëm në praninë e drogës.

Një person krijon varësi nga drogat pas përdorimit të vazhdueshëm dhe aftëgjatë të saj.

Personi i varur ka nevojë që të përdorë drogë që të ndihet normal ose që të mos ketë simptoma të pakëndshme të tërheqjes.⁴⁶

Vartësia mund të jetë fizike, psikologjike ose të dyja bashkë.

Një person i varur nga droga fizikisht është mësuar që të funksionojë me drogë. Një person që varet psikologjikisht nga droga, mendon se nuk mund të funksionojë siç duhet apo të arrijë kënaqësitë emocionale pa përdorur drogë.

4.1.3 Kriza e mungesës dhe shkallëzimi

Çdo drogë ka një kohëzgjatje të efektit veprues të saj. Problemi shtrohet se ç'ndodh më pas.

Rregulli i përgjithshëm është ky: sa më i madh të jetë efekti i drogës lidhur me kënaqësinë që ajo të jep, aq më i madh do të jetë efekti i kundërt, lidhur me hendekun, gjendjen depresive që vjen pas, ose sa më i ndritur realiteti nën efektin e drogës, aq më i zyrtë do të duket realiteti në mungesë të efektit të saj.⁴⁷

Shkallëzimi është një tjetër dukuri që lidhet me përdorimin e drogës. Ai karakterizohet nga përdorimi i drogave nga më të butat, tek më të fortat. Si rregull, narkomani fillon me një lloj droge, për shembull, me hashashin. Por, për shkak të tolerancës së organizmit, do të vijë një kohë që droga e parë nuk do të bëjë më efektin e mëparshëm. Krahas shtimit progresiv të dozave të së njëjtës drogë, ekziston edhe prirja që të ndodhë kalimi në një drogë më të fortë, ta zëmë nga hashashi te heroina. E keqja qëndron në faktin se e dyta është më e fuqishme se e para, rrjedhimisht më e rrezikshme.

⁴⁶ http://www.ishp.gov.al/multimedia/botime/broshure_droga.pdf

⁴⁷ Lekë Sokoli "Droga", shtëpia botuese "Rinia 2000". Fq.20

4.2 DUHANI-DROGË?

Duhani shkakton një vdekje në çdo dhjetë sekonda. Prej tij vdesin çdo vit tre milionë njerëz. Parashikohet se në vitin 2020 këto shifra të ngihen në dhjetë milionë në vit. Statistikat thonë se 45% e përdoruesve janë të moshës deri 18 vjeç dhe se 30% e 14-vjeçarëve e kanë provuar duhanin.⁴⁸ Duhani analizohet midis drogave thuajse në të gjithë literaturën që i kushtohet këtij problemi, për shkak të nikotinës që ai përmban.

Droga, duhani është një agjent (substancë, lëndë), i destinuar për të dhënë efekte psikike, që mbart rrezikun e abuzimit, të varësisë, tolerancës dhe të shumë pasojave të tjera negative vetjake e sociale. Duhani është përgjegjës për të ashtuquajturën “epidemi” të kancerit të mushkrive, sidomos në gjysmën e dytë të shekullit XX-të, duke çuar këtë kancer në numrin një të vdekshmërisë nga kanceri të meshkujt. Te femrat kanceri i mushkrive nuk ka rol parësor në vdekshmërinë, por rreziku prej tij është rritur çdo 10-vjeçar me rritjen e përdorimit të duhanit prej femrave.

Është vërtetuar se për çdo 20 cigare rreziku 15-fishohet. Kryesisht të pirësit e duhanit, moshë kur ky shfaq simptomat e kancerit është rreth 50-60 vjeçe dhe prej saj njeriu mund të përfundojë edhe në ndërhyrje të mundshme kirurgjike. Por, siç e thamë edhe më sipër duhani shkakton një listë të gjatë dëmsh. I ashtuquajturit bronkit astmatik shpeshherë e ka pikënisjen nga duhani. Personat, kur gdhihen në mëngjes, puna e parë që bëjnë fillojnë të kolliten dhe nxjerrin nga goja gëlbasë në sasi mesatare.

Te personat që nuk pijnë duhan mushkëritë me anë të sistemit ciliar (qelizat me “qime”), vetë pastrohen gjatë gjithë ditës, gjë që duhanpirësit nuk mundën ta bëjnë kur sistemi i tyre ciliar ka dalë jashtë funksionit dhe mushkëritë nuk janë në gjendje ta nxjerrin gëlbasën. Janë këta persona që sëmuren më shpesh nga infeksionet pulmonare.

Organizmit, pas lënies së duhanit i duhet një periudhë prej 40 ditësh që të prodhojë sasinë e duhur të Acetil-Kolinës. Gjatë kësaj kohe ish-duhanpirësve i shtohet stresi, nevrikosen edhe nga zhurma më e vogël, kanë pagjumësi etj. Por, të gjitha këto vështirësi kalohen me pak vullnet dhe këmbëngulje. Pirja e duhanit i shkakton dëme edhe aparatit tretës.

Kështu duhani jep rrezik të lartë për karcinomën e ezofagut. Kur kombinohet me pirjen e alkoolit ky rrezik shkon 150/1 në raport me popullsinë jo-duhanpirëse. Duhani, duke kontribuar në vazokonstrukcionin (ngushtimin) e enëve të gjakut të stomakut rrit përqindjen për ulcerin e stomakut, ndërkohë që rritet 2,7 herë rreziku për kancer-stomakun. Duhani shkakton shumë sëmundje dhe është i dëmshëm për shëndetin e njeriut.

Njerëzit mundohen ta lënë duhanin, por nuk mundën, pasi ata janë mësuar të konsumojnë shumë duhan. Disa njerëz mendojnë se duhani të largon dhimbjen e kokës, por duhani e shton akoma më shumë, por ne nuk e ndjejmë. Duhani është i ndaluar rreptësisht në ambientet publike.

Edhe **nikotina**, sikurse drogat, nxit varësinë fizike, por sidomos atë psikike. Tek ata që pinë shumë duhan shfaqet fenomeni i të mësuarit. Në këtë mënyrë ata e tolerojnë nikotinën, pa pasoja

⁴⁸ Lekë Sokoli “Droga”, shtëpia botuese “Rinia 2000. Fq.38

të mëdha në sasi dy deri tre herë më të mëdha nga një sasi e mjaftueshme për të krijuar reaksione toksike të një që nuk pi duhan.⁴⁹

Më tej: nikotina është shkaku i krizave të agrisivitetit, acarimit e nervozizmit, të dhimbjeve të kokës e të përzirave, pagjumësisë etj, që vërtetohen te një person sapo ai vendos të heqë dorë vesi i pirjes së duhanit. Këto janë simptomat e tërheqjes ose abstistencës, karakteristike për drogat. Mbidoza e duhanit, edhe pse shkakton komplikacione të natyrave të ndryshme, përgjithësisht nuk e çon njeriun në gjendje intoksikimi akut, megjithëse një paketë me 20 cigare përmban një sasi nikotine të mjaftueshme për të shkaktuar vdekjen e një personi: rreth 40-60 gramë. Ligji imponon vetë prodhuesit që të stampojnë në çdo paketë njoftime të tipit: “Duhani rrezikon seriozisht shëndetin”.



Fig.6.Duhani vret

4.3 Stresi dhe droga

Pavarësisht nga shkaqet që i shtyjnë njerëzit drejt drogës, stresi mbetet përherë i pranishëm. Ai është një “rrip transmissioani” që lidh njeriun me drogën. Në parimin “**redukto stresin që të mos përdorësh drogë**” do të bazohet, me sa duket, terapia antidrogë e së ardhmes. Është vështirë, pra, të mendosh që një i ri fillon të përdorë drogë pa patur një streës të brendshëm, qoftë edhe në formë latent (të fshehur).⁵⁰

Stresi dhe droga janë ngushtësisht të lidhur me njëri-tjetrin midis stresit dhe drogës ekziston një varësi e tillë: sa më të stresuar të jenë njerëzit në një shoqëri të dhënë, aq më i mundshëm është përdorimi i drogës dhe anasjelltas, sa më pak strese aq më pak drogë. Prandaj rrugët për mënjanimin e gjendjeve stresante janë, në një masë të madhe, edhe rrugët për të mos rënë në prehërin e drogës.

⁴⁹ Lekë Sokoli “Droga”, shtëpia botuese Rinia 2000. Fq.38.

⁵⁰ Lekë Sokoli “Droga”, shtëpia botuese Rinia 2000 . Fq.52-55

Njerëzit kërkojnë rrugëdalje nga situatat stresante. Por cilat janë alternativat për minimizimin e streseve?.⁵¹

1. **Sipas alternativës së parë:** një person në gjendje stresi mund të dalë në tregun e zi të drogës dhe t'i futet përdorimit të saj. Të fillosh aventurën e drogës edhe në kushtet e një stresi permanent është jo vetëm një veprim jologjik, por edhe joefiçent. Në raportin midis drogës dhe stresit kemi të bëjmë me një rreth vicioz. Droga të çliron momentalisht nga stresi, por në mungesë të saj kalohet në një, gjendje stresante më problematike se e para. Shuarja e saj do të kërkonte një sasi më të madhe droge, ose një drogë me efekte më të mëdha.
2. **Alternative e dytë:** mund të shkosh në një farmaci dhe të thuash, për shembull :” Më jepni një ilaç për stresin, që të më çlirojë në çastë, në pak minuta”. Farmacisti , pasi të pyet për problemin të jepë një drogë psikotrope. Me këtë akt ke filluar përdorimin mjekësor të drogave, shumë më i pranueshëm se përdorimi jomjekësor i tyre, i nevojshëm për kategori të caktuara njerëzish, por gjithsesi jo pa problem, të papritura e rreziqe.
3. **Alternativa e tretë:** në kushtet e një stresi të madh është e domosdoshme të konsultohemi me një mjek ose psikolog.
4. **Së fundi,** duhet pranuar që stresi është një fakt i jetës. Madje thuhet se për të qenë aktivë e produktivë kemi nevojë për pak stres. Është më e rëndësishme të jetosh me të, sesa të përpiqesh ta shmangësh plotësisht, duke përdorur drogë apo edhe barna psikotrope.

4.4 Droga dhe krimi. Të inkriminuar apo të sëmurë?

Pyetja nëse një i droguar duhet të konsiderohet si i inkriminuar apo thjesht si një i sëmurë, ka qenë prej kohësh objekt debatesh midis studimeve dhe eksepertëve. Ajo ka marrë përgjigje të cilat, sado të ndryshme, tentojnë në mënyrë të vazhdueshme në drejtimin e parë e jo në të dytin.⁵²

Kuptohet se kemi të bëjmë jo vetëm me një sëmundje, por edhe me një kategori njerëzish me rrezikshmëri të theksuar shoqërore. Nga ana tjetër, narkomanët edhe kur janë përdorues të thjeshtë të drogës, janë në kontakt të përhershëm me trafikantët e drogës, të cilët, për shkak të profesionit që kanë zgjedhur, janë në shumicën e tyre kontingjente të krimit. Përdoruesit e zakonshëm, si rregull, janë lehtësisht të përdorueshëm prej këtyre të fundit dhe në çdo kohë mund të shfrytëzohen për të kryer një krim ose për të marrë fajësinë e një krimi të kryer nga vetë trafikantët.

Në kërkim të një përgjigje sa më të plotë rreth pyetjes: të sëmurë apo të inkriminuar, le të analizojmë më tej. Kemi të bëjmë me inkrimin të mirëfilltë në rastet e trafikut të drogës e tregtimit, shpërndarjes së saj, të zotërimit edhe për përdorim personal të drogave të ndaluara me ligj, si dhe në rastet e krimeve të kryera qoftë për sigurimin e drogës, qoftë të atyre krimeve që

⁵¹ Po aty

⁵² Bruno Silvestrini “Droga” shtëpia botuese “Rinia 2000”

kryhen nën pushtetin e efekteve të saj.⁵³ Shumë njerëz mendojnë: nëse pasojat e përdorimit të drogës janë kryesisht rrjedhojë e veprimeve të vetë individit drogëpërdorues, atëherë nuk është detyrë e shtetit të ndryhyjë në to dhe veprime të tilla duhet të mos penalizohen. Ndërsa kundërshtarët përpiqen të argumentojnë se shteti ka një rol të caktuar si mbrojtës i jetës, shëndetit, madje edhe si mbrojtës moral i popullësisë që është subjekt i administrimit të tij. Termi krim pa viktima, nuk është plotësisht i saktë derisa sigurimi i drogës të lidhë me një rrjet të organizuar krimi. Nga ana tjetër përdorimi i drogës bën që të çlirohet ai agrisivitet, që në formë të fshehur, është i pranishëm te çdonjëri nga ne.

Sa kushton droga?

Droga është një mall, vlera e të cilit, normalisht duhet të përcaktohet nga puna shoqërisht e domosdoshme e harxhuar për prodhimin e tij. Nisur nga ky kriter drogat nuk do të ishin kaq të kushtueshme.⁵⁴ Por ajo që e bën drogën të kushtueshme është vështirsia e qarkullimit të këtij malli specifik, derisa ky qarkullim është një veprimtari e kundërligjshme dhe rrjedhimisht e rrezikshme.

4.5 TRAFIKIMI I DROGËS SHQIPËRI-MAQEDONI

Është një drejtim i parëndësishëm i trafikimit të drogës. Nga rastet e kapura nuk mund të flitet për një trafik të rregullt. Maqedonia ndodhet në rrugën e trafikimit të heroines për në Shqipëri, kështu që drogat e rënda nuk kanë pse të rikthehen përsëri aty. Megjithatë vërehen raste të trafikimit të drogës së lehtë vendase, cannabis sativa. Për këtë shfrytëzohet afërsia kufitare nga kultivuesit shqiptarë. Konstatohet se marihuana e trafikuar nga Shqipëria në Maqedoni është destinuar kryesisht për konsumatorët vendas. Kështu, në prill të vitit 2003, u kapën 4.65 kg marijuanë në Qafë Thane nga policia maqedonase. Marihuana ishte fshehur poshtë kabinës së shoferit me qese dhe shoferi M.R u arrestua. Rezultoi se droga destinohej për në tregun vendas. Ka patur edhe raste të trafikimit tranzit nga Shqipëria në Greqi, nëpërmjet Maqedonisë. Kështu doganierët maqedonas kapën në kufirin me Greqinë në një automjet me më shumë se 1.1 mariuanë, që ishte sjellë nga Shqipëria, në destinacion me Greqinë.

⁵³ Po aty.fq.57-59

⁵⁴ Lekë Sokoli "Droga", shtëpia botuese "Rinia 2000". Fq.70-71

4.5.1 Me çfarë drogohen shqiptarët?

Nga të dhënat që disponojmë rezulton se drogat e përdorura nga të rinjtë shqiptarë janë të larmishme: gati 2/3 e përdoruesve janë marijuanomanë, 20 për qind përdorin kokainë, 10 për qind heroinë dhe po kaq petidinë.⁵⁵ Ndërsa për marijuanën, kokainën dhe heroinën nuk ka ndonjë ndryshim domethënës midis djemëve dhe vajzave, për petidinën ai është i dukshëm: janë 13 për qind më shumë vajzat sesa djemtë përdorues të saj. Duhet mbajtur parasysh fakti se një numër i konsiderueshëm të rinjsh nuk përdorin gjithnjë të njëjtën drogë.

4.5.2 Kush e përdorin drogën?

Meshkuj apo femra

Sipas sontazhit tonë rezulton se drogëpërdoruesit janë në shumicën dërrmuese meshkuj. Respektivisht rreth 14 për qind e përdoruesve të drogës janë femra dhe 86 për qind e tyre janë meshkuj. Rezulton se fillimi i përdorimit të drogës lidhet me shumë me kuriozitetin. Nga kjo pikpamje nuk mund të thuhet se femrat janë më pak kurioze se meshkujt, përkundrazi. Megjithatë kurioziteti nuk i çon femrat aq masivisht drejt drogës.⁵⁶ Kjo falë vetpërmbytjes së tyre si dhe një shkallë më të lartë pjekurie që arrijnë ato, sidomos në periudhën e adoleshencës. Si rregull vajzat e marrin më seriozisht jetën.

Nga ana tjetër, nëse djemtë, siç rezulton, janë më të prirur drejt drogës se vajzat, kjo lidhet me shumë faktorë të tillë social si: miqësitë, mjedisi shoqëror, raportet e tyre me familjen, veçorit e rritjes apo veçori të tjera specifike që i karakterizojnë ata, sidomos në moshën e adoleshencës, e cila mendohet se është kohë e turbullimit dhe e stresit.

Kjo periudhë është plotë kundërshti. Pikërisht në moshën e adoleshencës vendoset, thuajse përfundimisht, nëse njerëzit do të prekin ose jo drogë gjatë jetës së tyre.

Djemtë janë më të prirur të prekin atë. Ata kalojnë më shumë në grupe shokësh, në klube e skuadra, diskoteka etj. Shkurtë: ata janë më afër rrugës. Ndonëse këto grupe janë kryesisht grupe të lira, përsëri ato bëjnë presion, imponojnë, tërheqin. Atje zhvillohet ndjenja për t'u dukur, për të rënë në sy, për t'u imponuar dhe për të imituar.

Gjithashtu është e njohur prirja e grupeve të djemve për të lëvizur drejt pozicioneve ekstreme si dhe dukuria e zgjedhjeve të rrezikshme.⁵⁷ Në këto grupe të djemve, gjithsesi të paqëndrueshme e pa synime të qarta, konflikti është shpesh i pranishëm. Ata janë më të prirur drejt sjelljeve devijante, kriminaliteti etj. Këto komplekse kalojnë në familje dhe shfaqen në formën e kontradiktave me prindrit. Logjika pse vajzat hyjnë në rrugën e drogës më pak se djemtë, lidhet shumë me faktin se ato janë më të lidhura me familjen dhe kontribuojnë më shumë për të.

⁵⁵ Lekë Sokoli "Droga", shtëpia botuese "Rinia" 2000 . Fq.88-89

⁵⁶ Lekë Sokoli "Droga", shtëpia botuese "Rinia" 2000 . Fq.91-93

⁵⁷ Po aty.

4.5.3 Motivet nxitëse për të filluar drogën

Sot, kur droga përdoret më shumë në vendet me shkallën më të lartë të qytetërimit e njëherësh me nivelin më të lartë të zhvillimit social-ekonomik, pra me mundësitë më të mëdha të plotësimit të interesave të qytetarëve të tyre, ky version duket mjaft i thjeshtëzuar. Për më tepër, është pranuar se kategorija e drogëpërdoruesve është po aq e larmishme sa edhe e jopërdoruesve të saj.⁵⁸ Një literaturë mjaft e gjerë për drogën nxjerrë në pah një varg faktorësh-psikologjikë, sociologjikë, kulturorë apo të gjendjeve e situatave para të cilave ndodhemi që përcaktojnë nëse një adoleshent përdorë drogë dhe një tjetër jo. Këta faktor janë, në faktë, motive nxitëse që të çojnë drejtë drogës. Të tillë janë kurioziteti rinor, presioni i grupit apo presioni i jashtëm shoqëror, stresi psikologjik, problemet ekonomike, dobësi të karakterit, drama familjare, rebelim adoleshence, negativizëm rinor, pamje iluzive e jetës apo rrugdaljeve nga monotonia e saj e shumë e shumë të tjera.

Duke gjykuar mbi motivet që i shtyejnë të rinjtë e sotëm drejtë drogës, mund të grupojmë:⁵⁹

1. Motive të karakterit manjakal, në të cilat përfshihen ato që lidhen me maninë për të provuar mollën e ndaluar, për të imituar dikë, thjeshtë për modë, për t'u dukur në grupin social etj.
2. Motive të natyrës melankolike, siç janë ato që lidhen me një situatë depressive, vetminë, mungesën e shpresës, nevojën për dashuri etj.
3. Motive impulsive ose flesh, siç janë ato që nxisin fillimin rrufe të përdorimit të drogës pas një fatkeqësie ose konflikti, dhunimi fizik etj.

4.5.4 Terapia ose si të shpëtojmë nga droga

Terapia është mjekimi i smundjeve me barna, pa ndërhyrje kirurgjikale. Terapia antidrogë përfaqëson trajtimin e narkomanëve me droga më të lehta dhe ilaçe, të cilat zvoglojnë efektet dhe krijojnë terrenin e nevojshëm për shkëputjen prej saj. Kjo është terapia mjekësore, e nevojshme por jo e mjaftueshme. Duke e parë problemin në rrafsh shumë më të gjërë, mund të përdorim termin terapi sociale. Një terapi e tillë ndaj drogëpërdorimit është tërsia e masave për të parandaluar, frenuar dhe luftuar drogën e përdorimin e saj, për shkëputjen e rehabilitimin shëndetësor e social të narkomanëve.

SI TË SHPËTOJMË NGA DROGA: vijmë te çështja se si ta përballojmë problemin? Cilat janë alternativat e mundshme dhe cila prej tyre është më e mira?

⁵⁸ Lekë Sokoli "Droga", shtëpia botuese "Rinia 2000" fq.104-108

⁵⁹ Lekë Sokoli "Droga", shtëpia botuese "Rinia 2000" fq.104-108

Sigurisht alternative e parë është parandalimi. Në trajtimin e problemeve sociale në përgjithësi e të drogës në veçanti, është vërtetuar një parim i tillë: kurimi i problemit është gjithnjë shumë më i vështirë dhe shumë më i kushtueshëm se parandalimi. Parandalimi nënkupton eliminimin e trafikut, që droga të mos preket nga njeriu.⁶⁰ Por ja që parandalimi nuk qenka plotësisht i mundur. Na mbetet të kërkojmë alternativa të tjera, pra metoda intoksikimi, për të shpëtuar prej saj.

Metodat e intoksikimit bazohen në dy parime themelore: **izolimi dhe zbrapsja**. **Izolimi** nënkupton shkëputjen e individit drogëpërdorues nga mjedisi në të cilin ai drogohet, pra nga shoqëria e drogës, për t'i shpëtuar tundimit të grupit që thërret, bënë presion dhe e tërheq me një forcë magnetike vështirësisht e përballueshme prej tij.⁶¹ Izolimi është një hap i domosdoshëm, por jo i mjaftueshëm që individ të shpëtoj nga droga. Sigurisht njeriu mund të përpiqet të shkëputet nga droga edhe në praninë e të droguarve të tjerë, pra duke mos u shkëputur nga rrethi shoqëror i mëparshëm.

Por përvoja ka treguar se kjo përpjekje nuk ka shumë sukses. Themi se izolimi është kusht i domosdoshëm, por jo i mjaftueshëm sepse ai, qoftë edhe si një izolim ekstrem, si ç'është burgu, për shembull, nuk të shkëput automatikisht nga droga. Duhet dëshira e individit, vullneti i tij e , më pas, ndihma e familjarëve, e shokëve e miqëve të vërtetë. Duhet, më në fund, edhe ndihma e specializuar, nëpër qendra terapie ose në mungesë të tyre, në spitale apo edhe në shtëpi, por gjithnjë nën kujdestarinë e një specialisti.⁶²

Duke e parë problemin në rrafsh social, mund të themi se shkëputja nga droga duhet shoqëruar me një situatë të re, me një status të ri social, me një angazhim të ri, për të mos ndjerë mungesën e saj, për të mos u rikthyer më tek ajo.

Ndërsa **zbrapsja** është process i kundërt i shkallëzimit. Nëse shkallëzimi është kalimi nga drogat e buta e të lehta, në ato të rënda e të forta, zbrapsja është zëvendësimi i drogave të rënda me më të lehta, me ilaçe psikotrope që, duke qenë droga, nuk kanë të njëjtën shkallë varësie, të njëjtin intensitet krizash të mungesës apo që nuk përfaqësojnë të njëjtin rrezik për individin, si droga e zëvendësuar.

4.5.5 Vullneti çelësi i artë

Per t'u çliruar nga droga, duhet vullnet. Ai është çelës i artë. Pa rifituar vullnetin narkomani nuk mund të çlirohet kurrë nga narkotikët, të cilët, ndër të tjera, janë vlerësuar si konsumues të tmerrshëm të vullnetit.⁶³ Madje veprimi shpërbërës i tyre mbi një individ shfaqet veçanërisht e me nuancë impresionuese mbi vullnetin. Individu dyzohet dhe, në çaste qetësie, vë re me tmerr pafuqinë e tij të paqëndrueshme për të ripërtirë vetëdijen dhe personalitetin e vet. Por si mund të shërohet një i droguar?

⁶⁰ Lekë Sokoli "Droga", shtëpia botuese "Rinia 2000" fq.127-128

⁶¹ Po aty.

⁶² Po aty.

⁶³ Lekë Sokoli, "Harry Box", "Droga", shtëpia botuese "Rinia 2000" fq.133-134

Kusht i dmosdoshëm është që ai të arrijë të zotrojë intelegjencën dhe të pushojë së menduari për drogën. Përvoja ka treguar se kjo mund të arrihet, të paktën gradualisht. Sigurisht është e vështirë të çlirohesh nga një zakon që të ka mbajtur skllav me muaj ose me vite.⁶⁴ Por, individ i vendosur për të rifituar personalitetin e vet dhe dominimin e vullnetit, duke përfutur nga një çast qetësie dhe ekuilibri, duhet të fikësojë në vetëvete qëllimin për të mos rënë, qoftë edhe përkohësisht në veset e zakonit të tij. Pra duhet vendosur për një periudhë abstenimi, për të mos marrë drogë për tre ditë, katër ditë, një javë.. Gjatë kësaj periudhe ai duhet të ripërtijë shpesh qëllimin e formuluar, duke kërkuar të bindë vetëveten se ai mund të dominon prirjen e vet për të përdorur drogë e të sundoj plotësisht vullnetin e vet. Ky proces shkon zinxhir: zgjatet abstenimi, rifitohet besimi, forcohet vullneti. Këto krijojnë terrenin që të kalohet në një fazë të dytë me më shumë besim, më shumë vullnet, më shumë kohë pa drogë.

Këto krijojnë premisat e një faze të re, të tretë, të katërt.. kështu do të ecet në mënyrë të shkallëzuar. Droga edhe mund të braktiset. Duhet kurajo. Nëse provon, do të shohësh se ngadalë, por në mënyrë progresive, do të arrish dominimin mbi vetveten, domethënë mbi drogën që bënë presion. Ditën që do të kuptosh se je plotësisht pardon i vullnetit tënd dhe se mund të bësh pa narkotikë, je i shpëtuar. Rregulli më i thjeshtë që do të të pengojë për të mos u rikthyer është: **“mos mendo më për të”**.⁶⁵

4.6 Toleranca ndaj drogës dhe mbidoza

Me fillimin e përdorimit të drogës individ i krijon tolerancë ndaj saj. Kjo do të thotë që për të marrë efektin e duhur përdoruesi duhet që të marrë gjithnjë e më shumë drogë.

MBIDOZA- Ndodh kur merret një sasi e tepruar droge dhe trupi nuk është në gjendje që t'a konsumojë, duke krijuar nivele të paabsorbueshme toksike në trup.⁶⁶ Mbidoza mund të çojë individin deri në vdekje. Në rastet kur nuk shkaktohet vdekje mund të mbeten dëmtime të trurit apo të organeve të trupit.

4.7 Parandalimi i përdorimit të drogës tek fëmijët dhe adoleshentët

Çfarë janë faktorët e rrezikut dhe ata mbrojtës?

Shumë faktorë janë identifikuar që ndihmojnë të dallojnë ata që abuzojnë me drogat nga ata që janë më pak vulnerabël në abuzim. Faktorë të shoqëruar me potencial më të madh për abuzim drogash janë quajtur faktorë “të rrezikut”, ndërsa ata të shoqëruar me potencial të ulët për abuzim

⁶⁴ Lekë Sokoli, “Harry Box”, “Droga”, shtëpia botuese “Rinia 2000”

⁶⁵ Lekë Sokoli, “Harry Box”, “Droga”, shtëpia botuese “Rinia 2000”

⁶⁶ Po aty.

janë quajtur faktorë “mbrojtës”.⁶⁷

Një faktor rreziku për një person nuk mund të jetë i njëjtë për një tjetër.

Për shembull, rreziqet e hershme, siç janë sjellje agresive jashtë kontrollit, mund të shihen tek një fëmijë shumë i vogël. Nëse nuk drejtohet drejt aksioneve prindërore pozitive, kjo sjellje mund të çojë në rreziqe të shtuara kur fëmija të mbarojë shkollën. Sjellja agresive në shkollë mund të çojë në mospranim nga bashkëmoshatarët, dënim nga mësuesit, dhe dështim akademik.

Përsëri, nëse nuk drejtohet nga ndërhyrje parandaluese, këto rreziqe mund të çojnë në sjelljen e menjëhershme që çon një fëmijë në rrezik për abuzim droge, siç janë shoqërimi me bashkëmoshatarë që abuzojnë me drogat.

Në fokusimin e mënyrës së rrezikut, programet e parandalimit të bazuara në studim mund të ndërhyjnë në zhvillimin e fëmijës për të forcuar faktorët mbrojtës dhe zvogëlimin e rreziqeve të zgjatura para se sjellja problematike të zhvillohet.

Për shembull, në sferën individuale sjelljet e hershme agresive tregojnë mungesë të kontrollit impulsiv, një çelës i faktorit mbrojtës. Duke ndihmuar një të ri të kontrollojë sjelljet impulsive është një fokusim i disa programeve parandalimi.

Faktorët e rrezikut për abuzim droge përfaqësojnë sfida për një zhvillim social, akademik, emocional të individit. Këta faktorë mund të prodhojnë efekte të ndryshme, në varësi të veçorive të personalitetit individual, fazë e zhvillimit dhe mjedisit.

Për shembull, shumë rreziqe serioze, siç janë sjelljet agresive të hershme dhe arritje e keqe akademike, mund të tregojnë që fëmija është në një rrugë zhvillimi të keqe e drejtuar drejt sjelljes problematike.

Tek të rinjtë që tashmë shfaqin faktorë të rrezikut serioz, vonimi i ndërhyrjeve deri në adoleshencë do t’a bëjë më të vështirë për të kaluar rreziqet.⁶⁸ Në adoleshencë, qëndrimi i fëmijës dhe sjelljet janë të krijuara dhe nuk ndryshojnë lehtë. Sa më shumë të jetë i shfaqur fëmija ndaj rrezikut, aq më shumë ai do të abuzojë me drogat. Disa faktorë të rrezikut janë veçanërisht të fortë dhe mund të influencojnë në abuzimin me drogat.

Duke patur një histori familje me abuzim substancash e pozicionon një fëmijë në rrezik për abuzim droge. Megjithatë, në një mjedis me bashkëmoshatarë jo abuzues me drogën, i riu ka më pak mundësi të bëhet një abuzues droge. Dhe prania e shumë faktorëve mbrojtës mund të minimizojë impaktin e disa faktorëve të rrezikut. Për shembull, mbrojtja e fortë – siç janë mbështetja dhe përfshirja – mund të zvogëlojë influencën e rreziqeve, siç janë qëndrimi me bashkëmoshatarë abuzues-substancash.

⁶⁷ http://www.ishp.gov.al/multimedia/botime/broshure_droga.pdf

⁶⁸ http://www.ishp.gov.al/multimedia/botime/broshure_droga.pdf

KREU V

5.CILAT JANË 5 KATEGORITË E PËRDORIMIT TË DROGËS?

Përdorimi eksperimental (Experimental use) ⁶⁹-Personi e provon drogën një apo dy herë sepse është kureshtar. Shumica e përdoruesve eksperimentalë nuk i dinë rreziqet që marrin parasysht kur marrin drogë. Ata janë në rrezik sepse trupi i tyre nuk është mësuar me drogën dhe nuk dihet se çfarë reagimi mund të ketë ai ndaj saj.

Përdorim argëtues (Recreational use)- Personi vendos që të marrë drogë për kënaqësi sidomos për të shijuar më shumë një gjendje emocionale apo një rast social.

Përdorim situatë (Situational use) -Personi e përdor drogën gjatë një situatë të caktuar. Për shembull, amfitaminat janë përdorur nga shoferët e kamionëve të mëdhenj për t'i ndihmuar që të qëndrojnë të vëmendshëm, ose prej atletëve për të rritur nivelet e energjisë. Disa shoferë taksish përdorin 'khat' për të qëndruar zgjuar gjatë orëve të gjata të punës. Personat që kanë kaluar trauma ose fatkeqësi shpesh kërkojnë prej doktorit që t'u jepen benzodiazepina (qetësues të lehtë) si ndihmë për të duruar dhimbjen.

Përdorim intensiv (Intensive use) -Personi përdor sasi të mëdha droge gjatë një periudhe të shkurtër, ose e përdor drogën vazhdimisht gjatë shumë ditëve apo javëve.

Përdorim i varur (Dependent use) -Personi bëhet i varur nga droga pas një përdorimi të gjatë ose të rëndë me kalimin e kohës. Vetëm një numër i vogël i përdoruesve bëhen përdorues të varur të drogës.

5.1 DROGAT DHE EFEKTET E TYRE

Një shqetësim i përgjithshëm është frika që një person që përdor drogë do të bëhet i varur nga droga dhe bëhet i varur nga droga.⁷⁰ Tregimet alarmante që dëgjojmë në lidhje me përdorimin e drogës japin përshtypjen që drogat ilegale të bëjnë të varur menjëherë dhe që këto janë drogat që shkaktojnë dëmet më të mëdha. Megjithatë asnjë drogë nuk është e menjëhershme për sa i përket varësisë dhe dëmet më të mëdha shoqërisë sonë i vijnë prej përdorimit të drogave legale si alkooli dhe duhani. Pavarësisht nga droga e përdorur, drogat e dëmshme kanë efekte tek përdoruesi e më tej. Përdorimi i drogës ndikon tek shëndeti, puna dhe jeta personale, dhe ndikon në familje dhe rrethin shoqëror.

⁶⁹ http://www.druginfo.adf.org.au/attachments/354_ëeb_ALBANIAN_DrugEffects.pdf

⁷⁰ http://www.druginfo.adf.org.au/attachments/354_ëeb_ALBANIAN_DrugEffects.pdf

5.1.1 Ndikimi tek individ

Probleme me shkollën ose punën-një person që përdor drogë mund të mos mësojë apo punojë ashtu siç duhet sepse ndjehet i lodhur dhe nervoz.⁷¹ Kjo mund të sjellë një ambient të pasigurt në punë sidomos nëse përdoruesi drejton automjete apo makineri të rënda. Përdoruesit e drogës mund të marrin më shumë ditë pushim për shkak të sëmundjeve dhe nuk janë në gjendje që të punojnë mirë.

Aksidentet-përdorimi i drogës ndikon tek personi duke pakësuar aftësinë për t'u përgjigjur shumë shpejt në situata të papritura. Ajo ndikon në aftësinë e të menduarit qartë dhe në mbajtjen e vëmendjes. Droga mund të shkaktojë shikim të dobët, ngërçe, të përziera dhe simptoma të tjera fizike. Këto efekte rritin mundësinë e aksidenteve rrugore, mbytjeve dhe kalimin e rrugës në mënyrë të pasigurt.

Probleme me shkeljen e ligjit- çdo shtet ka ligjet e veta që merren me prodhimin, mbajtjen dhe shpërndarjen e përdorimit të drogës. Përdorimi i drogës sjell probleme nëse nuk respektohet ligji dhe sjell probleme ligjore si për shembull sulme dhe krime të kryera me qëllimin e marrjes së të hollave për të vazhduar përdorimin e drogës.

Probleme financiare-kostoja e përdorimit të vazhdueshëm të drogës do të thotë që përdoruesi mund të mos ketë të holla të mjaftueshme për të blerë ushqime, veshje ose për të paguar faturat. Kjo sjell më shumë stres në familje.

Probleme shëndetësore-duhani, alkooli dhe drogat ilegale mund të shkaktojnë probleme të rënda shëndetësore nëse përdoren për një kohë të gjatë.⁷² Ngrënia e pakët dhe pagjumësia, duke qenë në efekte të drogës, ngrenë shancet e shfaqjes së një sërë ndërlikimesh shëndetësore. Personat që marrin drogë me injeksione janë në rrezik të marrjes së Hepatitit B, Hepatitit C dhe SIDË-s.

Probleme seksuale -disa droga e bëjnë një person të ndjehet shumë i eksituar nga ana seksuale. Megjithatë e njëjta drogë mund të shkaktojë probleme seksuale si impotencia.

⁷¹ http://www.druginfo.adf.org.au/attachments/354_ëeb_ALBANIAN_DrugEffects.pdf

⁷² Po aty.

5.1.2 Ndikimi në familje

Marrëdhëniet familjare dhe martesore—droga sjell konflikte me familjen ose shoqërinë. Për shembull nëse një person merr pjesë në mbledhje të gjata të përtypjes së ‘khat’ ai ose ajo kalon shumë kohë larg familjes.⁷³ Problemi keqësohet nëse ai vjen në shtëpi dhe fle në vend që të rrijë me familjen, është nervoz nga mungesa e gjumit ose ushtron dhunë dhe është i zemëruar pas mbledhjes së ‘khat’.

Familja dhe shoqëria mund të mërzhiten apo të shqetësohen kur manipulohen apo shtyhen për para, prona ose kur personi nuk e kupton se çfarë problemesh po i sjell droga.

Ndikimi tek anëtarët më të vegjël të familjes

Fëmijët marrin shembull prej prindërve, gjyshërve dhe vëllezërve apo motrave më të mëdhenj dhe mësojnë shumë prej tyre në sjellje dhe mendime për drogën në familje. Nëse një anëtar i familjes përdor drogë apo alkool për t’u çlodhur ose për të harruar një problem, edhe fëmijët do t’i përdorin këto metoda për t’u çlodhur ose për të zgjidhur një problem.

⁷³ http://www.druginfo.adf.org.au/attachments/354_ëeb_ALBANIAN_DrugEffects.pdf

5.1.3 Statistikat e veprave penale të kryera nga person i mvarur nga alkooli dhe substancat narkotike në periudhën 2014-2016 Kërçovë

Tabela nr. 1 Veprat penale në vitin 2014

Gjithësej vepra penale për vitin ka	328
Vepra penale ka	7
Përqindja	2,13%

Gjithësej vepra penale	7
Cënim i sigurisë në komunikacion	3
Vepra të rënda kundër sigurisë dhe njerëzve në komunikacion	2
Mundësimi i përdorimit të drogave narkotike	2

Gjinia mashkullore	7
Gjinia femrore	/
Lëndime trupore	3
Dëme material	2
Të vdekur	2
Dënim me të holla	2
Dënim me burg	5

Në bazë të statistikave të tabelës nr.1 mund të konstatojmë se nga numri i përgjithshëm i lëndëve nga viti 2014, 2,13% janë vepra penale në komunikacion të shkaktuar nga personat e varur nga alkooli.

Numri i përgjithshëm i fajtorëve në vitin 2014 është 7, ku të 7 personat i përkasin gjinisë mashkullore. Është shqiptuar dënim me të holla dhe dënim me burg, që mund të jetë deri në 1 vit burg mvaret nga vepra penale që ka kryer.

Nga viti 2014 do të marr një shembull që ka ndodhur:

Lënda 214/14 vepra penale është vepër e rëndë kundër sigurisë dhe njerëzve në komunikacion, neni 300 parag.4 ka bërë ndeshje në prezencë të alkoolit i cili ka pasur 1,41%.(promila). Veprën penale e ka shkaktuar **C.M** i lindur më 1975 nga Makedonski Brod . I cili ka shkel këmbësorin dhe prej lëndimeve të rënda trupore ka ardh deri te vdekja e personit **V.V**.

Dënimi: me burg deri në 1 vit.

Tabela nr. 2 Veprat penale në vitin 2015

Gjithësej vepra penale për vitin ka	234
Vepra penale ka	4
Përqindja	1,70%

Gjithësej vepra penale	4
Dhunë psikike	1
Vepra të rënda kundër sigurisë së njerëzve në komunikacion	1
Mundësimi i përdorimit të drogave narkotike	1
Prodhim i pa autorizuar dhe lëshim në qarkullim të mallrave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve	1

Gjinia mashkullore	4
Gjinia femrore	/
Lëndim psikik	1
Lëndime të rënda trupore	1
Dëme material	1
Dënimi me të holla	/
Dënimi me burg	4

Në bazë të statistikave të tabelës nr.2 mund të konstatojmë se nga numri i përgjithshëm i lëndëve nga viti 2015, 1,70% janë vepra penale në komunikacion të shkaktuar nga personat e varur nga alkooli.

Numri i përgjithshëm i fajtorëve në vitin 2015 është 4, ku të 4 personat i përkasin gjinisë mashkullore. Është shqiptuar dënim me të holla dhe dënim me burg që mund të jetë deri në 1 vit burg mvaret nga vepra penale që ka kryer.

Si shembull në vitin 2015 do të marrë:

Lënda 204/15, vepra penale prodhim i pa autorizuar dhe lëshimin në qarkullim të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve, neni 215 parag.2.

I akuzuari **SH.J** i lindur më 1993 , Kërçovë gjinia mashkullore, i akuzuar për shitje të pa autorizuar të marihuanës.

Blerësit e marihuanës **A.J dhe V.M** nga Kërçova.

Dënimi: 1 vit burg por me kusht nëse për 2 vite nuk e përsërisin të njëjtën vepër.

Tabela nr. 3 Veprat penale në vitin 2016

Gjithësej vepra penale për vitin ka	254- 89 pa vendos 165 të vendosme
Vepra penale ka	5
Përqindja	3,03%

Gjithësej vepra penale	5
Cënim i sigurisë në komunikacion	4
Prodhim i pa autorizuar dhe lëshim n qarkullim të mallrave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve	1

Gjinia mashkullore	5
Gjinia femrore	/
Lëndime trupore	4
Dëme material	2
Dënimi me të holla	2
Dënimi me burg	3

Në bazë të statistikave të tabelës nr.3 mund të konstatojm se nga numri i përgjithshëm i lëndëve nga viti 2016, 3,03% janë vepra penale në komunikacion të shkaktuar nga personat e varur nga alkooli.

Numri i përgjithshëm i fajtorëve në vitin 2016 është 5, ku të 5 personat i përkasin gjinisë mashkullore, ndërsa personi i cili ka marrë lëndime trupore nga cënimi i sigurisë në komunikacion i përket gjinisë femrore. Është shqiptuar dënim me të holla dhe dënim me burg që mund të jetë deri në 1 vit burg mvaret nga vepra penale që ka kryer.

Si shembull nga viti 2016 do të marrë rastin:

Lënda 55/16, vepra penale cënimi i sigurisë në komunikacion neni 297 parag.1 si dhe vepra e dytë penale është mos dhënie të ndihmës personit të lënduar në aksident komunikacioni.

I akuzuari **V.LL** nga Kërçova gjinia mashkullore, ka shkaktuar ndeshje në komunikacion me prezencë të alkoolit 1,96%.(promila) dhe nuk është ndalur t'i japë ndihmë të lënduarit gjegjësisht të dëmtuarit.

I dëmtuari **N.N** ka lëndime trupore si dhe dëme materiale.

Dënimi:dënim me të holla nga vepra e parë 30 gjoba ditore dhe nga vepra e dytë 15 gjoba ditore, dënim i vetëm 45 gjoba ditore ose 900 euro.

Tabela nr.4 Numri i përgjithshëm i lëndëve, të veprave penale të shkaktuara nga personi nën ndikim të alkoolit dhe substancave narkotike për periudhën 2014-2016

Gjithësej lëndë për periudhën 2014-2016	727
Vepra penale nën ndikim alkoolit dhe drogave narkotike	16
Numri i përgjithshëm i fajtorëve	16

Në bazë të statistikave të tabelës nr.4 mund të konstatojm se nga numri i përgjithshëm i lëndëve nga viti 2014-2016 është 727 ku janë vepra penale në komunikacion të shkaktuar nga personat e varur nga alkooli si dhe lëshim në qarkullim të mallrave narkotike, substancave psikotrope. Numri i përgjithshëm i fajtorëve në vitin 2014-2016 është 16, ku të 16 personat i përkasin gjinisë mashkullore, po ashtu edhe të lënduarit janë meshkuj në përjashtim të një femre që ka marr lëndime trupore. Është shqiptuar dënim me të holla dhe dënim me burg që mund të jetë deri në 1 vit burg apo më shumë.

KREU VI

6. MJEKIMI I DETYRUESHËM I ALKOOLISTËVE DHE NARKOMANËVE

Kjo masë e sigurisë nuk është e lidhur me kryerjen e veprës penale në gjendje të papërgjegjshmëris ose përgjegjshmëris esenciale të zvogëluar, por në gjendje të mvarshmërisë së autorit nga alkooli, drogës dhe substancave tjera psikotrope! Shqiptohet kur vepra penale është e kryer për shkak të varshmërisë së till, kurse gjyqi konstaton se ekziston rrezik që kryerësi për shkak të varshmërisë së tillë edhe në të ardhmen të kryej vepra të tilla.

Lidhja pasojore shkakore mes varshmërisë së autorit dhe veprës së kryer është kushti themelor për zbatim të kësaj mase.

Kjo para se gjithash nënkupton që vepra penale të jetë kryer në gjendje të lajthimit e nxitur me varshmërinë e kryerësit e cila nuk ka arritur shkallën e përgjegjshmëris esenciale të zvogëluar ose papërgjegjshmërisë. Po ashtu, nuk duhet të konstatohet si ka qenë gjendja e shkatërrës (lajthimit), por gjendja e varshmërisë lidhshmërisë së kryerësit me shfrytëzimin e përhershëm të pijeve alkoolike, drogës ose substancave psikotrope.

Nga ana tjetër varshmëria mund të paraqitet jo vetëm si faktor patologjik direkt, por edhe si motiv i kryerjes së veprës (vjedhje parash për të blerë alkool, falsifikimi i reçetave për të ardhur deri te substancat psikotrope etj).

Kushti i dytë është, vlerësimi për rrezikun e kryerësit që në të ardhmen të kryej vepra penale për shkak të varshmërisë së tij prej alkoolit, drogës ose substancave psikotrope. Në prognozimin për sjelljen e ardhshme të tij gjyqi duhet të mbështetet në mendimin e psikiatrit-

ekspertit. Por për dallim të masave të tjera të sigurisë për prognozë të tillë më shumë është relative shkalla dhe karakteri i gjendjes së varshmërisë, se sa vepra e kryer penale dhe me të të ngjajshme, e supozuar vepra e ardhshme.

Sipas natyrës së gjërave ky sanksion është inkompatibil me masat e sigurisë së mëparshme, sepse mjekimi i detyrueshëm psikiatrik dhe kujdesi në ente shëndetësore ose në liri i përfshinë rastet e rënda varshmërisë prej të cilave ka ardhur deri te kryerja e veprës në gjendje të papërgjegjshme ose përgjegjshme esenciale të zvogluar.

Kur kryerësit i është shqiptuar masa e tillë ajo përfshinë edhe shërim të varshmërisë nga alkooli, droga ose substancave psikotrope. Mjekimi i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve shqiptohet së bashku me **dënimin me burg** dhe realizohet në ente për kryerjen e dënimeve ose në ent shëndetësor ose ent tjetër të specializuar dhe koha e kaluar në ent të tillë llogaritet në dënim. Në këtë rast zgjatja e kësaj mase është e përcaktuar me zgjatjen e dënimit me burg. Kur është e shqiptuar me dënim tjetër përveç dënimit me burg ose dënim me kusht, dënimi me kusht është në mbikëqyrje të intesifikuar, vërejtje gjyqësore ose lirim nga dënimi , zgjatja e saj është e kufizuar në më shumë se dy vjet!⁷⁴

Gjatë shqiptimit, dënimit me kusht gjyqi mundet autorit t'i imponoj mjekim në liri nëse ai pajtohet t'i nënshtrohet mjekimit të tillë, nëse pa arsye nuk i nënshtrohet mjekimit në liri ose mjekimin e lëshon me vetëdëshirë, gjyqi mund të caktoj të revokohet dënimi me kusht ose masa të kryhet në mënyrë të detyrueshme në ente shëndetësore ose ente të specializuara.⁷⁵

Vepra kundërvajtëse, kryejnë personat kundërvajtësisht të përgjegjshëm, por edhe personat kundërvajtësisht të papërgjegjshëm. Personat të cilët në kohën e kryerjes së veprës penale kanë qenë kundërvajtësisht të përgjegjshëm, varësisht prej rrezikshmëris shoqërore të veprës kundërvajtëse, rrezikshmërisë së autorit të saj, shkallës së fajësisë, si dhe rrethanave lehtësuese dhe rënduese, gjykata kundërvajtëse i shqipton llojin dhe lartësinë e dënimit konkret kryesit të veprës kundërvajtëse.

Ndërkaq, personat të cilët në kohën e kryerjes së veprës kundërvajtëse kanë qenë kundërvajtësisht të papërgjegjshëm, për shkak të përdorimit të alkoolit ose mejteve narkotike, dhe për pasoj personi nuk ka qenë në gjendje të kontrollojë veprimet apo mosveprimet e tyre dhe as të kuptojnë se kryejnë vepër kundërvajtëse, përjashtohen nga dënimi kundërvajtës dhe gjykata u shqipton masën mbrojtëse-Mjekimin e detyrueshëm të alkoolistëve dhe narkomanëve.

Në jetën e përditëshme paraqiten raste kur persona të caktuar kryejnë vepra kundërvajtëse vetëm e vetëm se janë kundërvajtësisht të papërgjegjshëm, pra, kryejnë vepra kundërvajtëse si rezultat i varshmërisë së alkoolit ose narkotikëve për çka bëhen të paafte për të gjykuar dhe për të vendosur, por edhe janë të rrezikshëm për rrethin shoqëror.

Për të mënjeluar rrezikun permanent që këta persona në të ardhmen mos të kryejnë vepra penale, është detyr imanente e shoqërisë që ndaj këtyre personave të papërgjegjshëm dhe me

⁷⁴ Pelivanova, N. Merki na bezbetnost od medicinski karakter, Shkup 1996

⁷⁵ Tomiq, Z. Mjere bezbetnosti medicinskog karaktera, JRRK 1989/3

përgjegjshmëri esenciale të zvogluar të ndërmirren masa të caktuara mbrojtëse për t'i mënjeluar nga mundësia e përsëritjes së veprës kundërvajtëse në lëmin penal, por edhe për shërimin e tyre. Këtyre personave nuk mund t'u shqiptohen dënime kundërvajtëse, por mund t'u shqiptohet masa mjekimi i detyrueshëm të alkoolistëve dhe narkomanëve që konsiderohet si masë juridike kundërvajtëse e karakterit mjekësor.

Masat mbrojtëse e mjekimit të detyrueshëm të alkoolistëve dhe narkomanëve që u shqiptohen kryerësve kundërvajtës të papërgjegjshëm si rezultat i varshmërisë së alkoolit dhe drogës kanë një rëndësi të posaçme në kuadër të masave mbrojtëse kundërvajtëse që ndërmirren nga shoqëria për të luftuar kriminalitetin kundërvajtës dhe për të jetësuar qëllimin e dënimit kundërvajtës ndaj atyre të cilëve u shqiptohet kjo masë.

Mendojmë se, ligdhënësi nuk e ka shtruar mirë çështjen kur masa mbrojtëse e mjekimit të detyrueshëm të alkoolistëve dhe narkomanëve e ka përcaktuar si masë të vetme që mund t'u shqiptohet kryerësve penalisht të papërgjegjshëm. Papërgjegjshmëria na lajmërohet edhe për shkak të sëmundjeve psikike, çrregullimeve psikike por edhe zhvillimit psikik me të metë të cilat ndikojnë tek kryerësi kundërvajtës që në kohën e kryerjes së veprës kundërvajtëse të mosë ketë qenë në gjendje për të kontrolluar veprimet e veta e as për t'i kontrolluar sjelljet e veta. Edhe në të drejtën kundërvajtëse në lëmin penal, kemi raste të nduardurta të personave të cilët kryejnë vepra kundërvajtëse nga këto shkaqe, por në mungesë të sanksionit kundërvajtës- masës mbrojtëse adekuate nuk mund të ndëshkohen.

Masat mbrojtëse- Mjekimi i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve paraqet llojin e veçantë të sanksioneve kundërvajtëse të natyrës kurative të cilin e shqipton gjykata në procedurë gjyqësore ndaj kryerësve kundërvajtësisht të papërgjegjshëm, e i cili konsistojnë në mjekimin e kryerësit të kundërvajtjes dhe mënjanimin e gjendjeve, kushteve dhe rrethanave tjera, të cilat kanë kushtëzuar kryerjen e veprës kundërvajtëse, e që kanë për efekt jetësimin e qëllimit të dënimit kundërvajtës, luftimin e kriminalitetit kundërvajtës, mbrojtjen e paqes dhe qetësis publike dhe disiplinën e përgjithshme shoqërore.

Edhe mjekimi i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve, si masë mbrojtëse kundërvajtëse duhet të jetë i përcaktuar me ligj.

Baza juridike e shqiptimit të mjekimit të detyrueshëm të alkoolistëve dhe narkomanëve e cila shqiptohet ndaj kryerësve kundërvajtësisht të papërgjegjshëm, ose personave me përgjegjësi esenciale të zvogluar që është paraqitur si rezultat i varshmërisë, është gjendje e rrezikëshme permanente tek këta persona, të cilët edhe në të ardhmen mund të kryejnë vepra kundërvajtëse, për shkak të kësaj gjendje. M'u për këtë, kryerja e veprës kundërvajtëse “nuk është bazë e cila e arsyeton nevojën e shqiptimit të këtyre masave, por është vetëm kusht për shqiptimin e tyre”.⁷⁶ Për të mënjeluar rrezikshmërinë shoqërore që vjen nga personat kundërvajtësisht të papërgjegjshëm (e të cilët kanë kryer vepër kundërvajtëse), e që edhe në të ardhmen mund të kryejnë vepra kundërvajtëse e që ligjënsia kundërvajtës ka parapar mundësinë e shqiptimit të masave mbrojtëse të karakterit mjekësor, sepse këta persona gajtë kohës së kryerjes së veprës

⁷⁶ Mr.Zvonimir Tomiq, Masat siguruese të karakterit mjekësor, JRKKP, nr.3, Beograd, 1989, fq.51

kundervajtëse nuk kanë poseduar aftësinë për të gjykuar dhe as aftësinë për të vendosur, andaj shqiptimi i dënimit ndaj kësaj kategorije të personave është jo i drejtë dhe jonjerëzor. Më saktë, dënimi kundërvajtës ndaj këtyre personave është i papranueshëm, por edhe i padobishëm, sepse këta persona nuk janë të fajshëm. Dënimi kundërvajtës për këta persona është i pakuptimtë andaj edhe nuk shqiptohet.

Qëllimi i kësaj mase mbrojtëse kundërvajtëse është:

- Luftimi i kriminalitetit kundërvajtës dhe mbrojtja e vlerave juridike të përcaktuara me dispozita ligjore dhe nënligjore kundërvajtëse;
- Mënjanimi i gjendjeve dhe kushteve të cilat mund të ndikojnë te kryesi i veprës kundërvajtëse që edhe në të ardhmen të përsërisin veprën kundërvajtëse;
- Ndhurma ndaj kryerësit të veprës kundërvajtëse, e cila është e orientuar në shërimin e tij dhe rikthimin e tij në jetën normale.

Marrë në tërësi, kjo masë mbrojtëse është e drejtuar në mbrojtjen e shoqërisë dhe në jetësimin e preventivës speciale të qëllimit të dënimit kundërvajtës. Preventiva speciale e kësaj mase mbrojtëse, ka për efekt, në radhë të parë, shërimin e kryerësit të veprës kundërvajtëse, e në vazhdim riadaptimin dhe risocializimin e kryerësit të veprës kundërvajtëse në lëmin penal.⁷⁷

Mjekimi i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve konsiston në mjekimin e detyrueshëm në institucionin spitalor nga përdorimi i alkoolit, mjeteve narkotike ose mjeteve të tjera dehëse. Nëse kryerësi pa shkak të arsyeshëm nuk i nënshtrohet mjekimit të detyrueshëm ambulator në liri ose mjekimin e lëshon sipas dëshirës së vet, gjykata mund të caktojë sanksionin mjekim i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve, i cili kryhet dhunshëm në institucion të specializuar, mjekimi i detyrueshëm në institucion të specializuar mund të zgjasë më së shumti 2 vjet.⁷⁸

⁷⁷ Dr. Bajram Ukaj, dënimet në të drejtën penale të Shqipërisë, Prishtinë, 2006, fq.279-291

⁷⁸ Parag,3 l nenit 23 të Ligjit për kundërvajtje të Maqedonisë

6.1 PROCEDURA PËR SHQIPTIMIN E MASËS SË SIGURIMIT MJEKIM I DETYRUESHËM I ALKOOLISTËVE DHE NARKOMANËVE

Kryerësi i veprës penale i cili veprën penale e ka kryer për shkak të varësisë së tij nga përdorimi i vazhdueshëm i alkoolit ose i narkotikëve dhe tek i cili ekziston rreziku që për shkak të kësaj varësie të vazhdojë të kryejë vepra penale, gjykata mund t'i caktoj mjekim të detyrueshëm.⁷⁹

Për aplikimin e kësaj mase gjykata vendosë në kuadër të procedurës penale me aktgjykim pasi të sigurojë konstatimin dhe mendimin e ekspertit. Eksperti duhet të deklarojë në këtë rast edhe mbi mundësitë e mjekimit të pandehurit. Në qoftë se gjykata shqipton dënim me kushtë, atëherë këtë masë të sigurimit mund ta shqiptojë ashtu që kryerësi të mjekohet në liri. Mirpo, në qoftë se i pandehuri nuk është i nënshtruar mjekimit ose e ka braktisur në mënyrë arbitrare, gjykata pas dëgjimit të prokurorit publik, mund ta revokoj dënimin me kushtë ose të caktoj ekzekutimin e detyrueshëm të masës së mjekimit të detyrueshëm të alkoolistëve ose të narkomanëve në entin shëndetësor ose në ndonjë ent tjetër të specializuar. Para marrjes së vendimit, gjykata do të sigurojë, sipas nevojës, edhe mendimin e mjekëve.⁸⁰

6.2 TRAJTIMI ME ANË TË REHABILITIMIT TË DETYRUESHËM I PERSONAVE TË VARUR NGA DROGA DHE ALKOOLI

Trajtimi mjekësor i detyrueshëm i narkomanëve dhe alkoolistëve është masë e datës relativisht e re, e cila shqiptohet së bashku me sanksionet e caktuara penale dhe ka për qëllim që t'i evitojë rrethanat dhe shkaqet që kanë kontribuar në kryerjen e veprës penale. Rezultatet e hulumtimeve kriminologjike kanë treguar se narkomania dhe alkoolizmi janë faktorë të rëndësishëm kriminologjik. Gjithashtu hulumtimet shkencore kanë treguar se vetëm dënimi ndaj kryerësve, të cilët veprat penale i kanë kryer si alkoolistë apo narkomanë nuk mund të ushtroj efekte të duhura në luftën kundër kriminalitetit.

Në rastet e tilla trajtimi mjekësor, psikiatrik i tyre ka efekt më të madh preventive se dënimi. Me shqiptimin dhe ekzekutimin e masës së trajtimit me anë të rehabilitimit të detyrueshëm të narkomanëve dhe alkoolistëve, shoqëria mbrohet prej personave të cilët janë të prirur që nën ndikimin e drogës apo alkoolit të kryejnë vepra penale, por në të njëjtën kohë personave të këtillë me anë të mjekimit u jepet ndihmë që t'i çrrënjosin shprehitë, të lirohen nga varësia e konsumimit të drogës dhe alkoolit.

⁷⁹ Neni 65 i Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë

⁸⁰ Neni 532 i Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë

Këtë masë gjykata mund t'ia shqiptojë kryerstit penalisht të përgjegjshëm nëse plotësohen këto kushte:

- Që kryesit të veprës penale t'i jetë shqiptuar dënimi (dënimi me burgim, dënimi me gjobë, dënimi me kushtë), vërejtja e gjykatës apo lirimi nga dënimi;
- Që kryesi ta ketë kryer veprën penale për shkak të varshmërisë nga alkooli apo droga;
- Që të ekzistoj lidhja kauzale mes veprës penale të kryer dhe varshmëris së kryerësit nga droga apo alkooli ,përkatësisht që gjykata të konstatojë se faktori kryesor që ka motivuar kryerstin e veprës penale është varësia nga droga ose alkooli;
- Nëse ka gjasa për mejkimin e tij të suksesshëm.

Nga kjo që u tha rezulton se kjo masë mund të shqiptohet vetëm ndaj personave të cilët konstatohet se shkak kryesor i kryerjes së veprës penale është varshmëria e tyre nga droga apo alkooli.

Kjo masë nuk mund të shqiptohet ndaj personit i cili veprën penale e ka kryer nën ndikimin e drogës apo alkoolit, por i cili përndryshe nuk është i varur, nuk e ka të rrënjësuar shprehinë për konsumimin e drogës apo alkoolit. Në anën tjetër, për shqiptimin e kësaj mase nuk është e domosdoshme që personi në momentin e kryerjes së veprës penale të ketë qenë i dehur. Së këndejmi kjo masë e trajtimit mjekësor mund të aplikohet edhe ndaj narkomanit apo alkoolistit, i cili veprën penale e ka kryer në kohën kur nuk ka qenë nën ndikimin e drogës apo alkoolit, mirpo tek ai është rrënjësuar shprehia për konsumimin e tyre, dhe veprën penale e ka kryer p.sh. për të fituar mjete për të blerë drogë apo alkool.

Kjo masë ekzekutohet në entin shëndetësor apo në ndonjë ent tjetër të specializuar.

Mirpo, kjo masë mund të ekzekutohet edhe në entin për ekzekutimin e dënimeve, ku edhe gjendet kryesi në mbajtjen e dënimit me burgim. Në rastet kur kjo masë shqiptohet krahas dënimit me burgim, kjo ekzekutohet gjatë mbajtjes, gjatë kohëzgjatjes së këtij dënimi.

Nëse kjo masë shqiptohet krahas dënimit me gjobë, vërejtjes së gjykatës apo lirimit nga dënimi, gjykata mund të vendosë, me pëlqimin e të dënuarit, që masa e tillë e trajtimit të ekzekutohet në liri. Nëse kryesi pa ndonjë shkak të arsyeshëm nuk i nënshtrohet trajtimit në liri apo e braktisë në mënyrë arbitrare trajtimin , gjykata mund të urdhërojë që trajtimi të ekzekutohet në entin shëndetësor.

Nëse kjo masë e trajtimit të detyrueshëm është shqiptuar krahas dënimit me burgim, në kësi raste mund të zgjasë derisa të kryhet dënimi. Ndërsa në rastet kur kjo masë është shqiptuar krahas dënimit me gjobë, vërejtjes së gjykatës apo lirimit nga dënimi, trajtimi nuk mund të zgjasë më tepër se dy vjet. Në kësi raste gjykata duhet të shqyrtojë ekzekutimin e kësaj mase çdo dy muaj për të vendosur nëse është e nevojshme të vazhdohet ekzekutimi i masës.⁸¹

⁸¹ Dr.Ismet Salihu,e drejta penale pjesa e përgjithëshme,fq.529-531

6.3 DËNIMI ME KUSHT ME URDHËR PËR TRAJTIM TË DETYRUESHËM REHABILITUES

Gjykata mund të shqiptoj dënimin me kushtë me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues në rastet kur: personi ka kryer veprë penale për hërë të parë, personi veprën penale e ka kryer si rezultat i varshmërisë së alkoolit, drogës ose mjeteve tjera dehëse, gjykata vërteton se faktor kryesor që ka shkaktuar kryerjen e veprës penale është alkooli ose droga.

Trajtimi i sukseshëm rehabilitues ndaj kryesit të veprës penale do ta zvoglonte rrezikun për përsëritjen e veprës penale, është shqyrtuar raporti i shërbimit sprovues. Kohëzgjatja e dënimit me kusht me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues nuk mund të jetë më pak se 6 muaj e as më shumë se 3 vjet.

6.4 EKZEKUTIMI I TRAJTIMIT TË REHABILITIMIT TË DETYRUESHËM TË PERSONAVE TË VARUR NGA DROGA DHE ALKOOLI

Masa e trajtimit të rehabilitimit të detyrueshëm të narkomanëve dhe alkoolistëve është një ndër masat më të shpeshta të karakterit medicinal-social, që aplikohet në praktikën gjyqësore dhe në praktikën penitensiare.

Nga vetë emërtimi i saj, shihet se kjo masë ka të bëjë me ndërmarrjen e një trajtimi të veçantë të rehabilitimit ndaj personave të cilët kanë kryer sjellje delikuede dhe vepra penale në gjendje të varësisë nga droga apo nga alkooli. Fjala është për persona të cilëve konsumimi dhe përdorimi i alkoolit dhe pijeve narkotike u është bërë shprehë dhe të cilët, për këtë arsye janë bërë të varur dhe në këtë gjendje kanë kryer vepra penale. Përveç kësaj, ata paraqesin rrezik permanent për shoqërinë dhe mjedisin, sepse në gjendje të tillë mund të kryejnë vepra të reja penale.

Duke shqiptuar këtë masë, bëhet përpjekje që ata persona të shërohen dhe rehabilitohen në mënyrë që të ardhmen mos të përsërisin sjelljen kriminale. Lidhur me shqiptimin dhe ekzekutimin e kësaj mase në teorinë penologjike, ka mendime dhe pikëpamje të ndryshme. Në rendë të parë flitet për nevojën që këto masa të shërimit të ndërmirren para se personat e tillë të kryejnë sjellje devijante dhe kriminale.

Pra, ka mendime të cilat theksojnë se organet kompetente dhe shërbimet e ndryshme të specializuara duhet të kyçen në trajtimin dhe rehabilitimin e këtyre personave, para se ata të kryejnë vepra të rrezikshme penale. Sipas këtyre, nuk duhet pritur që personat e tillë të kryejnë vepra penale dhe të shkaktojnë pasoja të rënda për familjen dhe mjedisin ku jetojnë dhe punojnë. Në këtë mënyrë me siguri do të parandalohet fare aktiviteti i tyre eventual kriminal.

Nga ana tjetër, mendimet të cilat i kundërvihen këtij propozimi theksojnë se kjo masë duhet shqiptuar vetëm ndaj kryerësve të veprave penale, me qëllim që të pengohet keqpërdorimi, arbitrarizimi dhe shkelja e lirive dhe të drejtave të njeriut.

Në këtë drejtim, autorët të cilët i përkrahin këtë propozim, theksojnë se nga përvoja në shumë

vende vërehet se janë bërë keqpërdorime dhe njerëzit e caktuar janë shpallur si alkoolistë apo persona të sëmurë shpirtërisht dhe janë vendosur nëpër ente speciale psikiatrike, me qëllim të eliminimit të tyre nga trashëgimia, nga puna ose për arsye të rivalitetit politik apo në biznes etj. Sido që të jetë, këto mendime dhe dilema të ndryshme, nuk pengojnë që personat të cilët janë të varur nga konsumimi i drogave dehëse dhe alkoolit, të trajtohen dhe rehabilitohen, e sidomos kur kjo bëhet me iniciativë vullnetare të vetë këtyre personave ose të familjeve të tyre. Në raste të tilla, nuk ka kurrfarë pengese që personat e tillë të shërohen nëpër qendra psikiatrike në liri. Masa e trajtimit të detyrueshëm, mjekimi apo rehabilitimi i narkomanëve dhe alkoolistëve, ekzekutohet në institucione të specializuara vetëm për këtë dedikim. Masa e trajtimit dhe rehabilitimit të detyrueshëm të narkomanëve dhe alkoolistëve, mund të shqiptohet krahas dënimit me burgim ose si masë e pavarur.

Kur shqiptohet , krahas dënimit me burgim, së pari bëhet ekzekutimi i kësaj mase e pastaj i dënimit me burgim.

Institucionet e tilla, ku bëhet ekzekutimi i masës së trajtimit dhe rehabilitimit të detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve, kanë për detyrë që në mënyrë të rregullt të informojnë gjykatën për realizimin e tretmanit dhe shkallën e arritjes së shërimit të personave të tillë.

Në këtë informatë duhet të prezentohen të gjitha ecuritë e tretmanit, posaçërisht vështirësit dhe problemet të cilat paraqiten gjatë ekzekutimit të kësaj mase.

Shpeshherë në praktikë, ndodh që personat e këtillë të mos i përmbahen dhe nënshtrohen me përpikëri trajtimit dhe terapisë së caktuar.

Në raste të tilla, gjykata mund të ndërmerrë masa të tjera në drejtim të detyrimit të këtyre personave që t'i nënshtrohen trajtimit dhe terapisë së shërimit ose që këta persona të vendosen në ente të tjera.

Një veprim i këtillë, zakonisht ndërmirret ndaj alkoolistëve dhe narkomanëve të cilët shërohen në stacionare apo ambulanta shëndetësore në liri.

Në raste të tilla, gjykata vendos që ata të dërgohen në ente të veçanta dhe, në këtë mënyrë, të privohen nga mundësia e ikjes apo nënshtërimit të terapisë së shërimit.

Gjykata vendimin mbi shqiptimin e kësaj mase sipas ligjit të ri mbi, ekzekutimin e sanksioneve penale ia dërgon shërbimit sprovues kompetent, institucionit kompetent të kujdesit shëndetësor, institucionit korrektues ose institucionit përkatës për ekzekutimin e kësaj mase.

Nëse personi i dënuar në rastin e shqiptimit të kësaj mase gjendet në paraburgim gjykata gjithëashtu ia dërgon vendimin qendrës së paraburgimit ku ai është i vendosur.

Posa ta marrë vendimin e gjykatës, drejtori i Qendrës së paraburgimit e liron personin e dënuar në mënyrë që ai ti nënshtrohet tretmanit të rehabilitimit.

Institucioni kompetent i kujdesit shëndetësor, institucioni korrektues apo institucioni përkatës menjëherë kanë për obligim të informojnë shërbimin sprovues për faktin se personi i dënuar të cilit i është shqiptuar kjo masë nuk është duke iu përmbajtur programit të trajtimit

rehabilitees. Ndërsa shërbimi sprovues lidhur me këtë duhet t'i raportoj gjykatës kompetente. Shërbimi sprovues kompetent ka për detyrë t'i raportoj gjykatës edhe për realizimin dhe përfundimin e suksesshëm të programit të trajtimit rehabilites.

Gjykata kompetente pas marrjes së raportit në fjalë merr vendimin mbi pushimin e kësaj mase dhe vërteton se kjo masë është ekzekutuar përfundimisht.

KREU VII

8. Shkurtesat dhe akronimet

WHO- Organizatës Shëndetësore Botërore

OKB-Organizata e Kombeve të Bashkuara

AIDA-s-“Acquired Immunodeficiency Sindrom” që dmth sindrom e fituar nga virusi I cili dëmton sistemin e imunitetit të njeriut.

L.S.D- Lusergic Diethylomid Saure

8. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Një vepër penale kaq aktuale në vendin tonë e cila është e lënë pas dore dhe nuk merren masa të mjaftueshme në parandalimin e saj.

Prandaj studimi im kërkimor do të përqëndrohet në hulumtimin e alkoolizmit si dukuri socio-patologjike, fazat e alkoolizmit, lidhja me dhunën në familje dhe mënyrat tjera të abuzimit me alkool dhe substancat tjera narkotike.

Përdorimi i drogave përveç krimeve të lartpërmendura shkakton edhe disa pasoja tjera shoqërore. Në të shumtën e rasteve përdoruesit e drogave e tejkalojnë tolerancën (dozën e përditshme) e si pasoje e kësaj vjen deri te humbja e kontrollit dhe shkaktojnë një sërë veprash penale të parapara me ligje të ndryshme të Kodit penal të RM-së.

Nocioni viktimë përdoret për të shënuar personin i cili ka pësuar, është rrezikuar, është atakuar dhe është shkatërruar nga veprimi i kryerësit i cili nuk ka mundur që të kontrollojë sjelljet e veta për shkak se ka qenë në varshmëri të alkoolit. Si viktimë e krimit mund të paraqitet vetë individ, jeta dhe shëndeti i tij, prona, të drejtat dhe liritë e tij.

Abuzimi me alkool është një problem kompleks që përfshin përdorimin e rrezikshëm, përdorimin e dëmshëm dhe varësinë.

Përdorimi i rrezikshëm, siç përkufizohet nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, është «një zakon i përdorimit të alkoolit, që rrezikon të sjellë pasoja të dëmshme» fizike, mendore ose shoqërore.

Përdorimi i dëmshëm, i quajtur edhe abuzim me alkoolin, do të thotë se tashmë alkooli ka sjellë dëme fizike ose mendore, por ende nuk ka çuar në varësi. *Varësia* është përshkruar si «pafuqia për ta lënë pijen».

Nga përdorimi i drogës vjen deri te shfaqja e një numri të madh të veprave penale apo krimeve. Shumë herë personat për të siguruar drogë kryejnë vepra penale duke filluar nga vjedhjet, grabitjet, lëndimet trupore etj, e sidomos në raste të krizave edhe raste të dhunës në familje. Kryerja e këtyre veprave penale në të shumtën e rasteve janë të motivuar për përfitime personale ku personat me qëllim që t'i sigurojnë vetes të holla për të blerë drogë në mënyra ilegale apo në tregun e zi.

Këto vepra në të shumtën e rasteve janë vjedhjet e ndryshme duke filluar nga vjedhjet më të lehta deri tek ato më të rënda (vjedhjet me thyerje, grabitjet, vjedhjet grabitqare etj). Pastaj shumë nga veprat penale (krimet) kryhen edhe në fushën e trafikut ku personat nën ndikimin e përdorimit të drogave shkaktojnë aksidente të ndryshme të trafikut qofshin ato me dëme materiale, me lëndime të rënda trupore apo edhe fatalitet.

Dhuna në familje nuk është e rrallë dhe e pazakontë. Ka tregues që pikërisht në familje ndodhë një numër i madhë i dhunës së përhershme, të rëndë, të pamëshirshme me përmasa të gjëra, madje edhe në rastet me pasoja të rënda dhe fatale ku shkak kryesor është alkooli ose substancat narkotike.

Përdorimi i drogave, duke qenë i përditshëm e në vazhdimësi më i shpeshtë brenda ditës është shumë i kushtueshëm e pothuajse për shumicën e papërballueshëm materialisht, prandaj përdoruesit e drogave duke qenë në mungesë të mjeteve materiale për blerjen e drogave nuk zgjedhin mjete se si të arrijnë deri tek to.

Nga përdorimi i drogave personat vartës në mungesë të mjeteve materiale për t'i siguruar dozat e caktuara kryejn dhunë ndaj prindërve, bashkëshortëve apo edhe fëmijëve por ato gjithashtu mund të futen edhe në botën e prostitucionit që përbën po ashtu një lloj kriminaliteti.

Nga kjo dukuri më së shumti janë të rrezikuara përdorueset femra, ku për ta siguruar dozën, në mungesë të parave detyrohen të ushtrojnë prostitucion, e së fundmi në vendin tone nga kjo dukuri nuk janë të përjashtuar as edhe përdoruesit meshkujt.

Gjithashtu ne këtë punim kemi bërë analiza reale të rrethit ku jetoj nga gjykata themelore e Kërçovës, duke analizuar rreth 727 lëndë nga sektori penal, nga ku pastaj kam bërë një statistikë të posaçme të paraqitur në tabela, në një periudhë kohore prej tre viteve nga 2014-2016 tek të cilat mund të shohim përqindjen e lartë që zëjnë aksidentet si vepra penale të kryera nga personat nën ndikimin e alkoolit dhe substancave narkotike, në krahasim me numrin e përgjithshëm, të të gjithë veprave të kryera brenda këtyre viteve ku nga 727 lëndë, ku 9 prej tyre janë aksident në trafik nga ndikimi i alkoolit.

Poashtu mund të vërejm dhe lartësinë e dënimeve dhe llojet e dënimeve të cilat i ka shqiptuar Gjykata Themelore e Kërçovës, ku si përfundim mund të them që më së shumti është shqiptuar dënimi me të holla (ose gjoba ditore), si dhe dënimi me burg. Si kryerës të këtyre veprave penale më së shumti paraqiten gjinia mashkullore.

Në Gjykatën Themelore të Kërçovës kishte një sërë veprash penale por mund t'i quajm si numra të errët për shkak se kishte shumë vepra penale të vjedhjes por ato nuk mund t'i cekja në këtë punim shkak është se përderisa e kanë bërë vjedhjen mund të kenë qenë nën ndikimin e alkoolit ose drogës. Por ato persona mund të kapen një muaj mbas dhe atehër nuk janë nën ndikimin e alkoolit dhe ky fakt nuk më la që ti cekja në tezën time.

Dëshiroj që të mos vijë deri te viktimizimi nga përdorimi i këtyre substancave, prandaj shpresoj që të dhënat që kam dhënë në këtë punim të shërbejnë në vetëdijsimin e popullatës për të kontribuar në parandalimin e këtij fenomeni shumë të dëmshëm si për individin ashtu edhe për shoqërinë.

9. BIBLIOGRAFIA

- WHO Global Status Report on Alkool,2004,f.54-8
- Sylen Vranica:Narkomania,Prishtinë,1998,f.84-90
- A.Ramljak dhe H.Haliliovic:vep.e cit,f.252-255
- R.Halili,Kriminologjia,2005,f.312-313
- F.Schmalleger vep.e cit,f.636-637, M.Demolli Narkomanët s'kanë ku të kurohen "Gazeta Lajm"10.05.2007,f.15
- Po aty
- T.Markovic:Alkoholizam,Zagreb,1956,fq.12-124
- R.Halili:Aspekte juridike dhe kriminologjike të alkoolizmit dhe narkomanisë.Përparimi, nr.2. Prishtinë,1984,fq.173-185
- S.Stoiljkovic:Narkomanija kao socio-medicinski problem.Bcograd.1972,fq.8-10
- S.Petrovic:Droga ljudsko ponasanje,Beograd.1983,fq.61-63
- M.Nicovic:Opojne droge multinacionalna kompanija kriminala,Zagreb.1989,fq.9-10
- Z.Shita:Aspekti psikiatrik I toksimanive,botuar në Problemi shoqëror I alkoolizmit dhe narkomanisë në Kosovë,Prishtinë,1984,fq.49-50
- S.Vranica:Narkomania, Prshtinë,1998 fq 18-25 dhe31-40
- H.D.Schëind,vep e cit,fq.526-528
- I.J.Siegel.vep.e cit.fq.364-366 dhe 367-369
- S.Vranica vep. E cit..fq 135-145
- D.Kozaric,K.Nenadic,T.I,jubin:Sociopatoloshka obeljezja narkomana I osoba saporemecajem licnosti Zagreb,1996, fq.18-22,23-27
- St.Petrovic,vep.e cit. fq 233-234 dhe 236-237
- Lyle.Ë.Shanon:Alcohol and Drugs Deliquency and Crime,London, 1998,fq.147-150, 155-163
- I.Glick,vep e cit. fq.350-354
- R.Halili:Aspektet juridike dhe kriminologjike të alkoolizmit dhe narkomanisë. Përparimi nr.2. Prishtinë,1984,fq.177-178 dhe 183-184
- Pelivanova,N.Merki na bezbetnost od medicinski karakter, Shkup 1996
- Tomiq,Z,Mjere bezbetnosti medicinskog karaktera,JRKK 1989/3
- Mr.Zvonimir Tomiq,Masat siguruese të karakterit mjekësor, JRKKP,nr.3, Beograd, 1989,fq.51
- Dr. Bajram Ukaj, dënimet në të drejtën penale të Shqipërisë, Prishtinë, 2006,fq.279-291
- Parag,2 I nenit 23 të Ligjit për kundërvajtje të Maqedonisë
- Parag,3 I nenit 23 të Ligjit për kundërvajtje të Maqedonisë
- Dr.Ismet Salihu,e drejta penale pjesa e përgjithëshme,fq.529-531
- Prof.dr.Ragip Halili,pjesa e posacme e të drejtës penale,fq.101-102
- Neni 204 I Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë

- Dr.M.Milutinovic, Kriminologjia, Beograd,1981, fq.373
- Po aty;
- T.Krlev,Kriminologjia na soobraqajnata delikvencija,Skopje,1998,fq.198
- Dr.Markovic,Maloljetnicka delikvencija I njezino suzbivanje, Beograd,1973,fq.173
- Dr.B.Tomovski,Droga sëmundje e së sotmes, Shkup ,1995,fq.10
- Prof.Dr.Ragip Halili,Kriminologjia, Prishtinë, 2005,fq,308
- Lekë Sokoli “Droga”, shtëpia botuese”Rinia 2000” fq.17
- Po aty.fq.18
- Po aty. Fq.18
- Lekë Sokoli “Droga”, shtëpia botuese”Rinia 2000 . Fq.20
- Lekë Sokoli “Droga”, shtëpia botuese”Rinia 2000. Fq.38
- Lekë Sokoli “Droga”, shtëpia botuese”Rinia 2000 . Fq.52-55
- Po aty
- Bruno Silvestrini “Droga” shtëpia botuese “Rinia 2000”
- Po aty.fq.57-59
- Lekë Sokoli “Droga”, shtëpia botuese”Rinia 2000 . Fq.70-71
- Lekë Sokoli “Droga”, shtëpia botuese”Rinia 2000 . Fq.88-89
- Lekë Sokoli “Droga”, shtëpia botuese”Rinia 2000 . Fq.91-93
- Po aty.
- Lekë Sokoli “Droga”, shtëpia botuese”Rinia 2000 . Fq. 93-98
- Lekë Sokoli “Droga”, shtëpia botuese”Rinia 2000” fq.104-108
- Po aty.
- Lekë Sokoli “Droga”, shtëpia botuese”Rinia 2000”fq.127-128
- Lekë Sokoli “Droga”, shtëpia botuese”Rinia 2000” fq.128-131
- Po aty.
- Lekë Sokoli,”Harry Box”, “Droga”, shtëpia botuese”Rinia 2000”fq.133-134
- http://www.ishp.gov.al/multimedia/botime/broshure_droga.pdf
- http://www.ishp.gov.al/multimedia/botime/broshure_droga.pdf
- http://www.ishp.gov.al/multimedia/botime/broshure_droga.pdf
- http://www.ishp.gov.al/multimedia/botime/broshure_droga.pdf
- http://www.druginfo.adf.org.au/attachments/354_ëeb_ALBANIAN_DrugEffects.pdf
- http://www.druginfo.adf.org.au/attachments/354_ëeb_ALBANIAN_DrugEffects.pdf
- <http://www.slideshare.net/ermaltroksi/projekt-droga>